EPOKA E RE
E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5534
E martë, 24 korrik 2018
çmimi 0.40 €

## Ekrem Bardha në vitin 1986 fitoi betejën e parë kundër Jugosllavisë

FAQE 12-13




Shkruan: Ferdinand SAMARXHI,
*Fitues i Antenës së Artë / Mjeshtër i Madh*

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", AGIM BAHTIRI FAQE 4-5

# Shkëmbimi i territoreve të mos jetë pjesë e dialogut



Nënkryetari i Aleancës Kosova e Re (AKR), njëherësh kryetar i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, u ka bërë thirrje institucioneve të Kosovës të mos lejojnë që shkëmbimi i territoreve të jetë pjesë e dialogut me Serbinë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se as çështja e kufijve administrativë nuk duhet të jetë pjesë e agjendës së dialogut dhe se Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe duhet të jetë në kuadër të kompetencave të Kushtetutës së Kosovës. Bahtiri i ka bërë thirrje spektrit politik t'i anashkalojnë partitë dhe të arrijnë pajtim në mënyrë që Kosova të përfaqësohet me njerëz të devotshëm dhe të aftë në bisedimet me Serbinë. Ai ka thënë se në këtë proces duhet të shkohet me një platformë të përbashkët, të studiuar mirë, dhe që Kuvendi duhet ta ketë rolin kryesor

## AKTUALE

LIBERALIZIMI SI POLITIZIM DHE ILUZION F. 13



Ismet RASHITI

PARKINGU NËNTOKËSOR NË KRYEQYTET DO TË KUSHTOJË 15 MILIONË EURO F. 11

FILLON PAGESA PËR KOMISIONARËT E ANGAZHUAR NË ZGJEDHJET E FUNDIT F. 6

## EKONOMI

NË VJESHTË NIS AKSIONI PËR PASTRIMIN E KOSOVËS F. 9

LIROHET NGA AKUZA MINISTRI VALDRIN LLUKA F. 8

## KULTURË

VUSHTRRIA ORGANIZON SHTATË DITË FESTË PËR MËRGIMTARËT F. 10

## SPORT

EMRI I FADIL VOKRRIT ZBUKURON STADIUMIN E PRISHTINËS F. 18

MAVRAJ: ME SHQIPËRINË DUA EVROPIANIN F. 18

# Veseli bën thirrje për konsensus politik për dialogun me Serbinë



Partitë opozitare e kanë bojkotuar të hënën takimin e thirrur nga kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ku temë diskutimi ishte arritja e konsensusit lidhur me temën e dialogut të ardhshëm Kosovë - Serbi. Në takim ishin të pranishëm vetëm përfaqësuesit e partive të koalicionit qeverisës. Pas këtij takimi, Veseli i ka bërë thirrje opozitës për konsensus politik për dialogun me Serbinë FAQE 8

## Korrjet në përfundim, bereqet pak

Shirat e shpeshta, dëmtimet nga breshëri dhe koha e vranët kanë qenë shkaktarët që këtë vit asnjë sipërfaqe me grurë nuk ka arritur t'i mbulojë shpenzimet e kombajnës as 50 për qind të çmimit të saj.



RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
SatStyro
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax.: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

## Përmbytje në Shqipëri

TIRANË, 23 KORRIK - Përmbytjet janë fenomen me të cilin shqiptarët janë mësuar çdo dimër. Por, tashmë vërshimi i ujit në qytete kryesore është një dukuri që po ndodh edhe në mes të verës. Ka mjaftuar një orë shi gjatë së hënës dhe qendra e Shkodrës dhe e Durrësit janë përmbytur nga uji. Fotografitë dhe videot që qytetarët kanë postuar në rrjetet sociale tregojnë për një situatë të paprecedent që reshjet kanë krijuar brenda pak minutave. Në shumë qytete të vendit dendësia e tyre ka bërë që niveli i ujit të shkojë në disa centimetra, duke vështirësuar qarkullimin, apo shkaktuar edhe përmbytje. Në qytetin e Shkodrës, për shkak të reshjeve të shumta, është përmbytur edhe Spitali rajonal i Qytetit, si dhe zona të tjera përreth. Pamjet janë shpërndarë nga deputetja e Partisë Demokratike në qarkun e Shkodrës, Izmira Ulqinaku, nëpërmjet një postimi në llogarinë e saj në rrjete sociale.
Në video shfaqet uji që është futur në katin e parë të spitalit dhe vërshon nëpër korridore e salla të spitalit. Problematike ka qenë situata edhe në zonat e tjera të qytetit.



# Partitë arrijnë marrëveshje për Qeveri teknike në Maqedoni

Maqedonia do të bëhet me Qeveri teknike. Partitë në pushtet kanë pranuar formimin e një qeverie teknike para referendumit të pritshëm për ndryshimin e emrit të Maqedonisë. Ky model do të praktikohet para të gjitha zgjedhjeve parlamentare

SHKUP, 23 KORRIK - Partitë në pushtet në Maqedoni kanë pranuar formimin e një qeverie teknike para referendumit të pritshëm për ndryshimin e emrit të Maqedonisë. Ky model do të praktikohet para të gjitha zgjedhjeve parlamentare. Ndërkohë, drejtuesit e partive kryesore të pushtetit dhe të opozitës pas më shumë se tetë orë diskutimesh nuk arritën t'i afrojnë qëndrimet në lidhje me pyetjen që do të shtrohet në referendum, për karakterin e tij dhe për datën kur duhet të mbahet referendumi.
Kryeministri Zoran Zaev, i cili është edhe kryetar i Lidhjes Social Demokrate, u tha gazetarëve se Qeveria e pranoi shumicën e kushteve të opozitës për shkak të interesave kombëtare. Zaevi shprehu bindjen se Maqedonia do të jetë anëtare e NATO-s dhe e BE-së, ndërsa akuzoi rivalin e tij politik për çështjen e referendumit. "Mickovski nuk ka pranuar t'u bëjë thirrje përkrahësve të partisë së tij që të dalin në referendum dhe të votojnë sipas bindjeve të tyre. Mickovski gënjen kur thotë se dëshiron anëtarësimin e Maqedonisë në BE dhe NATO", akuzoi kryeministri Zaev. Në qeverinë teknike do të marrë pjesë edhe VMRO-DPMNE-ja, e cila aktualisht është partia më e madhe opozitare.
Zoran Zaev (LSDM), Hristijan Mickovski (VMRO-DPMNE), Ali Ahmeti (BDI) dhe Bilall Kasami (Lëvizja BESA) janë marrë vesh për formimin e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve që duhet ta organizojnë referendumin dhe për Kodin Zgjedhor, që duhet të votohet nga shumica prej dy të tretave në parlament.
Po ashtu, katër drejtuesit partiakë janë marrë vesh për mënyrën e financimit të partive. KShZ-ja do të formohet ashtu si edhe më parë dhe jo me një shumicë të thjeshtë prej 61 votash të ligjvënësve siç planifikonte fillimisht shumica parlamentare. Referendumi për ndryshimin e emrit të Maqedonisë duhet të mbahet këtë vjeshtë. Në bazë të marrëveshjes me Greqinë, emri i ri i Republikës ish-Jugosllave do të jetë "Republika e Maqedonisë së Veriut".




# Roth: Shqipëria në rrugë të mirë drejt integrimit në BE



TIRANË, 23 KORRIK - Ministri i Shtetit për Çështjet Evropiane në Ministrinë e Jashtme gjermane, Michael Roth, gjatë konferencës së përbashkët me ministrin për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati, përgëzoi Shqipërinë dhe Qeverinë e saj për reformat e ndërmarra për ta afruar vendin drejt BE-së. "Kam ardhur për ta përgëzuar Shqipërinë për sukseset e saj dhe se Shqipëria është në një rrugë mjaft të mirë drejt Bashkimin Evropian. Shqipëria ka marrë nga Komisioni Evropian një rekomandim pozitiv për nisjen e bisedimeve të anëtarësimit. Në qoftë se gjithçka do të vijojë në këtë mënyrë, unë jam i bindur se vitin e ardhshëm kjo do të bëhet realitet dhe jam i bindur se Shqipëria do ta vijojë kursin e vet të reformave. Në radhë të parë këtu bëhet fjalë për ndërtimin e një shteti ligjor të fortë dhe solid, për vijimin e një sistemi drejtësie të pavarur, sikurse edhe për një luftë të vendosur kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit", theksoi Roth.
Duke u ndalur te procesi i vettingut si një nga kushtet kryesore për integrimin e Shqipërisë, Roth theksoi se ky proces ka qenë i suksesshëm dhe tregues për këtë është largimi i 14 gjyqtarëve dhe prokurorëve që tashmë nuk janë më pjesë e sistemit. "Në procesin e vetting-ut Shqipëria ka ecur në një rrugë e cila nuk ka të dytë dhe se Shqipëri ka treguar se ky proces ka qenë i suksesshëm. Fakti që deri tani 14 gjykatës dhe prokurorë të cilët janë shkëputur nga sistemi, tregon se njerëzit e kanë kuptuar se Qeveria është serioze kur flitet për krijimin e një sistemi të pavarur drejtësie. Por këto reforma duhet t'i ndiqni në mënyrë të vazhdueshme dhe një sërë elementësh i bëri të ditura edhe ministri Bushati në fjalën e tij, pra duhet të jeni të vendosur në rrugën e reformave", u shpreh ministri Roth.

## Basha: Jemi në situatë grushtshteti

TIRANË, 23 KORRIK - Pas mbledhjes së grupit, Lulzim Basha doli në një deklaratë për mediat, ku foli për Ligjin e magjistraturës, duke u shprehur se mazhoranca e ka kapur këtë shkollë, e cila mund të quhet tashmë një shkollë partie. "Ligji për magjistraturën është maturuar vetëm me votat e mazhorancës, në mënyrë të tillë që, pasi ta kapnin këtë shkollë, asnjë parti tjetër të mos ndërhyrnte. Ajo është tani një shkollë partie. Ky është një institucion i kapur totalisht nga Edi Rama. Njerëz të lidhur me PS-në prej një apo dy brezash. Synohet një kapje afatgjatë e sistemit", tha Basha.
Më tej, Basha u shpreh se Magjistratura nuk e zgjidh mungesën e Gjykatës Kushtetuese. "Nëse reforma në drejtësi do të funksiononte, atëherë Saimir Tahiri do të ishte në burg", tha kreu i PD-së.
Basha foli për kërkesat dhe qëllimet e PD-së mbi situatën në sistemin e drejtësisë: "T'i qëndrojmë besnik konsensusit të 21 dhe 22 qershorit 2016. Zgjidhja e situatës së paligjshmërisë në organin e prokurorisë, duke i dhënë fund kapjes politike të prokurorit të përgjithshëm. Zgjidhja e situatës së paligjshmërisë për kandidatët e KLGJ dhe KLP. Ky proces është i pavlefshëm bazuar në ligj, pasi këta anëtarë duhet të zgjidhen në bazë të kushtetutës. Zgjidhje urgjente e ngërçit në Gjykatën Kushtetuese, jemi në situatë grushtshteti", tha Basha.



EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Përfaqësuesit e partive të koalicionit qeverisës kanë diskutuar rreth dialogut Kosovë - Serbi, opozita ka bojkotuar këtë takim

# Veseli bën thirrje për konsensus politik për dialogun me Serbinë

Partitë opozitare e kanë bojkotuar të hënën takimin e thirrur nga kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ku temë diskutimi ishte arritja e konsensusit lidhur me temën e dialogut të ardhshëm Kosovë - Serbi. Në takim ishin të pranishëm vetëm përfaqësuesit e partive të koalicionit qeverisës. Pas këtij takimi, Veseli i ka bërë thirrje opozitës për konsensus politik për dialogun me Serbinë



EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 23 KORRIK - Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kadri Veseli, ka zhvilluar të hënën një takim me përfaqësues të subjekteve politike parlamentare, në funksion të arritjes së konsensusit lidhur me temën e dialogut të ardhshëm Kosovë - Serbi. Në një adresim para medieve, kryeparlamentari Veseli ka thënë se në takim morën pjesë vetëm përfaqësues të subjekteve politike në koalicionin qeveritar edhe pse, sipas tij, për takime të tilla ka bërë thirrje vetë opozita. "Konsensusi i brendshëm ka qenë një traditë e mirë qe e kemi pasur dhe rezultatet janë historike. Në takimin e sotëm kanë marrë pjesë vetëm përfaqësuesit e pozitës. Kërkesa e sotme ka qenë më shumë kërkesë e opozitës, për çfarë duhet publikisht ta falënderoj ambasadorin e Amerikës dhe përfaqësuesen e BE-së për iniciativat", ka deklaruar kryeparlamentari Veseli.

Kreu i Kuvendit ka pohuar se ulja në tavolinë me Serbinë është sakrificë dhe jo privilegj. "Me Serbinë duhet biseduar për hir të fëmijëve tanë dhe sakrificës për ta ruajtur këtë që e kemi arritur deri më tani. Ky është obligim dhe përgjegjësi e gjithë spektrit politik. Mesazhi që duhej ta dërgonim do të ishte mesazhi i unitetit konsistent se Kosova është shtet i pavarur dhe sovran dhe sovraniteti është i pacenueshëm", ka deklaruar Veseli, teksa ka shtuar se do të jetë Kuvendi i Kosovës ai që do të ketë rol vendimtar në procesin e dialogut.

Duke folur për refuzimin e opozitës lidhur me dialogun, Veseli ka theksuar se mungesa e lidershipit tek to ka krijuar një situatë ku nuk ka ende pjesëmarrje të opozitës në dialog ani pse, sipas tij, një pjesë e saj e ka pranuar një gjë të tillë. "Një pjesë e opozitës ka pranuar të marrë pjesë në dialog. Nevoja e akomodimit, apo mungesa e lidershipit, ka krijuar një situatë ku nuk kemi ende një pjesëmarrje të opozitës në dialog. Në emër të patriotizmit po krijohet një populizëm, me qëllim të përfitimit. Qëllimi i takimit ka qenë të krijohet formati dhe vijat për të cilat duhet të diskutohet në dialog", ka thënë Veseli, duke shtuar se shteti i Kosovës është i shenjtë dhe sovraniteti i Kosovës është i pacenuar.

# Kosova, e sfiduar në planin e jashtëm

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 23 KORRIK - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka zhvilluar të hënën një vizitë pune në Ministrinë e Punëve të Jashtme, ku është pritur nga zëvendëskryeministri, njëherësh ministër i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, me bashkëpunëtorë. Me këtë rast, kryeministri Haradinaj ka ofruar mbështetjen e tij për projektet dhe planet konkrete të Ministrisë së Punëve të Jashtme, duke thënë se së bashku me ministrin e Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, kanë punuar shumë rreth politikës së jashtme të Kosovës, duke e konsideruar politikën e jashtme temë mjaft të rëndësishme për Kosovën. "Kemi filluar punën si Kosovë në planin e jashtëm të sfiduar në planin politik, të sigurisë, por edhe në atë ekonomik. Beteja diplomatike për Kosovën është bartur edhe të shumë vende të largëta rreth njohjeve. Po ashtu, kemi vështirësi të tjera edhe në regjion dhe në integrimet euroatlantike, pra jemi shumë të sfiduar në planin e jashtëm", ka thënë kryeministri Haradinaj, duke shtuar se, pavarësisht prej faktit që janë të sfiduar, Ministria e Punëve të Jashtme dhe ministri Pacolli kanë bërë punë të mrekullueshme duke mos lejuar prapësimin e pozicionit të Kosovës në planin diplomatik, edhe në ato vende të largëta ku ka qenë një target i oponentëve tanë.




*Kryeministri Ramush Haradinaj gjatë një takimi që ka zhvilluar të hënën me ministrin e Punëve të Jashtme, Behgjet Pacollin, ka bërë me dije se Kosova është shumë e sfiduar në planin e jashtëm. Pavarësisht prej faktit se janë të sfiduar, kryeministri ka theksuar se Ministria e Punëve të Jashtme dhe ministri Pacolli kanë bërë punë të mrekullueshme duke mos lejuar prapësimin e pozicionit të Kosovës në planin diplomatik*

Më tej, kryeministri Haradinaj ka theksuar se kanë plane dhe projekte konkrete. Ai ka thënë se sa herë që ka lajme pozitive do t'i bëjnë të njohura për publikun, siç ishte lajmi për rekomandimin pozitiv për liberalizimin e vizave, duke i siguruar të gjithë qytetarët e Kosovës, se në planin e jashtëm politika e Kosovës është unike.

Ndërsa zëvendëskryeministri, njëherësh ministër i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, duke e cilësuar shumë të rëndësishme vizitën e parë të kryeministrit Haradinaj, për të dhe ministrinë të cilën ai e udhëheq, e informoi kryeministrin për të gjitha punët që janë bërë gjatë kësaj periudhe, si dhe për angazhimet e diplomacisë së Kosovës në çështjen e lobimit për shtimin e njohjeve të reja, rregulloren e re të MPJ-së, bashkëpunimet bilaterale, multilaterale dhe rajonale, integrimet euroatlantike, anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës, në UNESCO, Interpol si dhe sfida të tjera me të cilat është duke u përballur kjo ministri. Po ashtu, ministri Pacolli e ka informuar kryeministrin Haradinaj rreth procesit të bashkëpunimit të Evropës Juglindore, kryesimin e së cilës vitin tjetër do ta marrë Republika e Kosovës.

Flet për "Epokën e re", Agim Bahtiri

# Shkëmbimi i territoreve të



Nënkryetari i Aleancës Kosova e Re (AKR), njëherësh kryetar i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, u ka bërë thirrje institucioneve të Kosovës të mos lejojnë që shkëmbimi i territoreve të jetë pjesë e dialogut me Serbinë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se as çështja e kufijve administrativë nuk duhet të jetë pjesë e agjendës së dialogut dhe se Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe duhet të jetë në kuadër të kompetencave të Kushtetutës së Kosovës. Bahtiri i ka bërë thirrje spektrit politik t'i anashkalojnë partitë dhe të arrijnë pajtim në mënyrë që Kosova të përfaqësohet me njerëz të devotshëm dhe të aftë në bisedimet me Serbinë. Ai ka thënë se në këtë proces duhet të shkohet me një platformë të përbashkët, të studiuar mirë, dhe që Kuvendi duhet ta ketë rolin kryesor

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 23 KORRIK - Nënkryetari i Aleancës Kosova e Re (AKR), njëherësh kryetar i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka bërë me dije se nga takimi i hënës me përfaqësuesit e partive politike, shoqërisë civile dhe organizatave të ndryshme, është nxjerrë një deklaratë e përbashkët e cila përmban tri kërkesa lidhur me dialogun Kosovë - Serbi. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se kërkesa e parë është që shkëmbimi i territoreve dhe çështja e kufijve administrativë nuk duhet të jenë pjesë e agjendës së dialogut të Brukselit. Po ashtu, ai u ka bërë thirrje që Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe duhet të jetë në kuadër të kompetencave të Kushtetutës së Kosovës. "I kam ftuar përfaqësuesit e të gjitha partive politike, shoqatave të ndryshme, shoqërisë civile si dhe intelektualët për të biseduar për procesin e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë. Qëllimi i këtij takim ka qenë ndarja e Kosovës apo shkëmbimi i territoreve të mos jetë pjesë e dialogut. Kërkesa ime ka qenë që të debatohet rreth kësaj çështje dhe të merret një vendim nëpërmjet të cilit kërkohet nga ata që dialogojnë me Serbinë, që ndarja e Kosovës të mos jetë në rend të ditës në tavolinën e bisedimeve. Prandaj i bëj thirrje Qeverisë së Kosovës, sidomos grupit punues që do të jetë në Bruksel, të bëjë përpjekje maksimale që kjo çështje të mos jetë në agjendën e dialogut", është shprehur Bahtiri.

Ai i ka bërë thirrje spektrit politik t'i anashkalojnë partitë dhe të arrijnë pajtim në mënyrë që Kosova të përfaqësohet me njerëz të devotshëm dhe të aftë në bisedimet me Serbinë. Bahtiri ka thënë se në këtë proces duhet të shkohet me një platformë të përbashkët të studiuar mirë dhe se Kuvendi duhet ta ketë rolin kryesor. "Politikanët duhet të ulen dhe të mendojnë pak më gjatë për arsye se askush nuk e ka të drejtën të marrë vendime personale e partiake, por është Kuvendi i Kosovës i cili mund të marrë vendim për delegacionin që do t'i udhëheqë bisedimet me Serbinë. Ky delegacion duhet të jetë gjithëpërfshirës si dhe duhet të zgjedhen njerëz me dinjitet për ta mbrojtur shtetin e Republikës së Kosovës. Unë po shpresoj se kjo do të ndodhë deri në shtator, kur edhe do të përcaktohen pikat e rendit të ditës", ka deklaruar ai.

**"Epoka e re":** *Z. Bahtiri, të hënën keni mbajtur një takim me përfaqësues të partive politike, shoqërisë civile si dhe organizatave të ndryshme. Mund të na tregoni se cili ka qenë qëllimi i këtij takimi?*

**Bahtiri:** I kam ftuar përfaqësuesit e të gjitha partive politike, shoqatave të ndryshme, shoqërisë civile si dhe intelektualët për të biseduar për procesin e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë. Qëllimi i këtij takimi ka qenë ndarja e Kosovës apo shkëmbimi i territoreve të mos jetë pjesë e dialogut. Sepse Mitrovicës i dhemb fort ndarja meqë qyteti është i ndarë në të dyja anët e lumit Ibër. Kërkesa ime ka qenë që të debatohet rreth kësaj çështje dhe të merret një vendim përmes të cilit kërkohet nga ata që dialogojnë me Serbinë, që ndarja e Kosovës të mos jetë në rend të ditës në tavolinën e bisedimeve. Për këtë

# mos jetë pjesë e dialogut



kam marrë përkrahjen e të gjitha partive politike, me përjashtim të disa personave që thonë se e përfaqësojnë PDK-në. Prandaj i bëj thirrje Qeverisë së Kosovës, sidomos grupit punues që do të jetë në Bruksel, që të bëjë përpjekje maksimale që kjo çështje të mos jetë në agjendën e dialogut.

**"Epoka e re":** *Përveç kësaj, ka pasur ndonjë kërkesë tjetër nga ky takim?*
**Bahtiri:** Në fund të takimit kemi nxjerrë një deklaratë të përbashkët me tri kërkesa. Kërkesa e parë është që çështja e kufijve mos të jetë pjesë e negocimit, kërkesa e dytë është që Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe mos t'i kalojë kompetencat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe kërkesa e tretë ishte që të mos diskutohet rreth çështjes së kufijve administrativë. Këto kanë qenë kërkesat tona të cilat ia kemi drejtuar Qeverisë së Kosovës.

**"Epoka e re":** *Besoni se këto kërkesa do të merren parasysh nga Qeveria dhe nga presidenti si udhëheqësi kryesor i dialogut?*
**Bahtiri:** Kërkesat tona janë të drejta dhe në të mirë të qytetarëve si dhe pa pretendime partiake. Shpresoj se ata që do të shkojnë në Bruksel për të negociuar do ta kenë parasysh këtë deklaratë dhe këto kërkesa. Delegacioni i bisedimeve me Serbinë duhet ta marrë miratimin e Kuvendit të Kosovës meqë delegacioni që ka shkuar deri më tani në Bruksel nuk është i unitetit dhe nuk mund ta përfaqësojë shtetin e Kosovës. Kosovën në këtë dialog mund ta përfaqësojnë vetëm ata që i ka zgjedhur Kuvendi, të cilët duhet të raportojnë para deputetëve për çdo bisedë që zhvillohet në Bruksel.

**"Epoka e re":** *Si e shihni vazhdimin e këtij procesi dhe sa ka gjasa të arrihet uniteti politik për këtë çështje?*
**Bahtiri:** Politikanët duhet të ulen dhe të mendojnë pak më gjatë për arsye se askush nuk e ka të drejtën të marrë vendime personale e partiake, por është Kuvendi i Kosovës i cili mund të marrë vendim për delegacionin që do t'i udhëheqë bisedimet me Serbinë. Ky delegacion duhet të jetë gjithëpërfshirës si dhe duhet të zgjedhen njerëz me dinjitet për ta mbrojtur shtetin e Republikës së Kosovës. Unë po shpresoj se kjo do të ndodhë deri në shtator, kur edhe do të përcaktohen pikat e rendit të ditës. Prandaj u treguam atyre se populli nuk dëshiron të futet në rend të ditës çështja e territoreve dhe nëse këta veprojnë kundër popullit, atëherë populli sigurisht do ta japë përgjigjen e vet si sovran i këtij vendi.

**"Epoka e re":** *Ju po kërkoni që ekipi negociator të jetë gjithëpërfshirës, por si mund të ndodhë një gjë e tillë kur opozita refuzon të bëhet pjesë e këtij procesi?*
**Bahtiri:** Edhe pozita edhe opozita duhet të kthehen në Kuvend, në mënyrë që ky institucion ta zgjedhë grupin punues për të negociuar. Mendoj se edhe opozita është duke kërkuar një gjë të tillë. Kur është në pyetje ndonjë çështje madhore e shtetit të Kosovës unë jam mbipartiak dhe kërkoj nga secili të jetë mbipartiak, sepse populli dhe shteti i Kosovës është mbipartiak. Kur të bisedohet për shtetin e Kosovës askush nuk bën të thirret në emër të partisë apo të grupit, por duhet të thirret në emër të qytetarëve dhe të sovranitetit të Republikës së Kosovës. Prandaj kërkesa ime për spektrin politik është t'i anashkalojnë të gjitha partitë politike dhe të ulen të bisedojnë në mënyrë të mirëfilltë duke bashkëpunuar dhe duke ofruar njerëz të devotshëm dhe të aftë për të biseduar me Serbinë. Po në këtë proces duhet të shkohet me një platformë të përbashkët të studiuar mirë dhe jo të shkohet me një letër të pastër dhe me një kimik në dorë. Pra, duhet të shkohet me një platformë e cila paraprakisht duhet të debatohet në Kuvend dhe në pjesën e inteligjencës së Kosovës, pastaj të ofrohet ajo që është më e mira për vendin. Kjo duhet të ndodhë dhe i ftoj të gjithë krerët e partive politike të bashkëpunojnë në këtë rrafsh për arsye se është në interes të popullit dhe të vendit.

**"Epoka e re":** *Ka kohë që deri në shtator të hartohet kjo platformë dhe Kuvendi ta ketë rolin kryesor në fazën finale të dialogut?*
**Bahtiri:** Nëse mendohet për shtetin dhe qytetarët dhe jo për partinë dhe bajraktarizmin, mendoj se kjo do të arrihet shumë shpejt. Unë i ftoj të gjithë liderët të ulen dhe të bisedojnë në mënyrë që të arrijnë një unitet politik në të mirë të shtetit dhe të këtij populli të vuajtur, i cili ka derdhur shumë gjak për këtë vend sepse nuk duhet të shkelet mbi gjakun e dëshmorëve.

**"Epoka e re":** *Z. Bahtiri, çfarë është duke ndodhur me urën e Ibrit e cila është dashur të lëshohet për qarkullim së shpejti?*
**Bahtiri:** Personalisht kam qenë pjesë e bisedimeve me Serbinë kur është bërë marrëveshja për revitalizimin e urës së Ibrit. Kjo është çështje e zgjidhur, sepse tani punimet janë në fazën përfundimtare. Para dhjetë ditësh kemi qenë në takim me shefen e BE-së në Kosovë, Natalya Apostolova, së bashku me kryerin Goran Rakiq dhe jemi marrë vesh që punët të kryhen gjatë këtij muaji. Shpresoj se kjo do të ndodhë. Hapja e urës do të bëhet me një ceremoni solemne, ku do të jenë të ftuar edhe zyrtarët e Brukselit.

**"Epoka e re":** *Javën e kaluar është raportuar se atje po ndërtohet edhe një mur ndarës?*
**Bahtiri:** Ai mur nuk është pjesë e ndarjes, por pjesë e ndarjes së rrethrrotullimit në pjesën e shëtitores. Pjesa e parë është 40 centimetra, kurse pjesa e dytë dhe e tretë janë nga 70 centimetra, ku do të mbillen lule dhe ajo është për mbrojtjen e fëmijëve që mund të bien viktimë e komunikacionit të rrethrrotullimit në pjesën e veriut sikur që janë në të gjitha vendet evropiane. Kjo mendoj se është puna më e mirë që është bërë deri më tani. Shpresoj se së shpejti do të bëhet përurimi i urës në mënyrë që të ketë lëvizje të lirë në atë pjesë. Unë jam duke punuar ngushtë me qytetarët për të mirën e tyre. Falënderoj popullin e Mitrovicës për mbështetjen e vazhdueshme!

# Shoqëria civile kërkon që reforma zgjedhore të vendoset me prioritet

**Prishtinë, 23 korrik (ER)** - Nëntëmbëdhjetë organizata të shoqërisë civile përmes një deklarate për medie kanë adresuar mangësitë në legjislacionin zgjedhor. "Janë bërë shtatë vjet prej kur ka filluar reforma zgjedhore dhe asnjëherë nuk ka përfunduar dhe nuk ka ndonjë ndryshim thelbësor në këtë drejtim", është thënë në deklaratën e këtyre organizatave, për të shtuar se me qëllim të ngritjes së përfaqësimit qytetar dhe rritjes së cilësisë së të zgjedhurve, me qëllim të konstituimit dhe konsolidimit të shpejtë dhe të qëndrueshëm të institucioneve, në mënyrë që të sigurohet më shumë funksionalitet i sistemit politik, transparencë dhe llogaridhënie të subjekteve politike dhe administrim më të lehtë të procesit zgjedhor, organizatat e shoqërisë civile kanë ftuar subjektet politike dhe Kuvendin e Kosovës të: Vendosin me prioritet në agjendë çështjen e reformës zgjedhore që adreson problematikat e vërejtura në proceset e kaluara zgjedhore dhe ta bazojnë punën në analiza dhe hulumtime; të sigurojnë që legjislacioni zgjedhor është reflektim i të gjitha grupeve të interesit, duke garantuar gjithëpërfshirje dhe respektim të vullnetit të të gjithë qytetarëve pavarësisht prej përkatësisë së tyre gjinore apo etnike; dhe t'i marrin parasysh rekomandimet nga organizatat e shoqërisë civile dhe nga misionet e vëzhgueseve të zgjedhjeve të organizatave vendore dhe ndërkombëtare. Po ashtu, organizatat e shoqërisë civile shprehin gatishmërinë për të kontribuar në procesin e adresimit të mangësive të legjislacionit zgjedhor me ekspertizën e tyre për të siguruar zgjedhje të lira dhe të drejta në të ardhmen.



# MSh-ja nënshkroi kontratat me OJQ-të për ruajtjen dhe përparimin e shëndetit

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 23 KORRIK - Ministria e Shëndetësisë ka nënshkruar sot kontratat me 31 organizata joqeveritare, përfituese të mbështetjes financiare nga thirrja publike për financim të projekteve të OJQ-ve në fushën "Ruajtja dhe përparimi i shëndetit". Me rastin e nënshkrimit të këtyre kontratave, ushtruesi i detyrës së sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë, dr. Naim Bardiqi, ka thënë se objektivi i përgjithshëm i thirrjes për propozime ishte realizimi i aktiviteteve që i kontribuojnë ruajtjes dhe përparimit të shëndetit, si dhe forcimi i partneritetit dhe bashkëpunimit me organizatat joqeveritare që veprojnë në këtë fushë. Ai ka theksuar se me rastin e përzgjedhjes së OJQ-ve fituese është zbatuar në mënyrë transparente rregullorja e Ministrisë së Financave Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

31 OJQ-të fituese do t'i realizojnë projektet për edukim dhe promovim të shëndetit; përmirësimin e shëndetit të grupeve të cenueshme; rehabilitimin fizikal dhe mendor të grupeve të cenueshme dhe përkujdesjen shëndetësore ditore jashtë spitalore dhe shtëpiake. Vlera totale e planifikuar e thirrjes publike ishte 400 000.00 euro, kurse shuma minimale e projekteve individuale ishte 1 500.00 euro dhe ajo maksimale 99 000.00 euro. OJQ-të kanë pasur mundësi të aplikojnë me më së shumti një projekt në kuadër të thirrjes publike, kurse periudha e zbatimit të projekteve fituese është 6-8 muaj.



# Fillon pagesa për komisionarët e angazhuar në zgjedhjet e fundit

EPOKA E RE Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 23 KORRIK - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka njoftuar se gjatë këtyre ditëve ka dërguar në Ministrinë e Financave (MF) listën për pagesë të një pjese të stafit të angazhuar në procesin zgjedhor 2017. "Duke u mbështetur në kufizimet buxhetore dhe pamundësinë për t'i përmbyllur të gjitha pagesat në këtë kohë, njoftojmë se pagesat kanë filluar të realizohen për 1 126 persona nga gjithsejtë 1 748 të cilët kishin mbetur pa paguar deri në përfundim të vitit të kaluar. Pra, transferimi i mjeteve, që pritet të përmbyllet të martën (24 korrik), është bërë në llogaritë aktive të 1 126 personave të cilët kanë qenë të angazhuar në komuna të ndryshme të Kosovës si: komisionarë; personeli për raportimin e rezultateve preliminare (K-Vote); dhe në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve. Mjetet janë siguruar nga buxheti i KQZ-së, saktësisht nga projektet të cilat kanë pasur të realizohen në këtë pjesë të dytë të këtij viti", ka njoftuar KQZ-ja.

KQZ-ja ka bërë me dije se sapo të sigurohen mjetet financiare do të paguhen edhe personat e tjerë që kanë qenë të përfshirë në procesin zgjedhor. "Gjithashtu, njoftojmë se pagesa për pjesën e mbetur, 622 persona, do të bëhet sapo të sigurohen mjetet e nevojshme dhe për këtë do të informohen me kohë. Pra, këtu përfshihen 455 persona nga Komuna e Klinës dhe 167 të tjerë nga Komuna e Prizrenit. Duke pasur parasysh se Zgjedhjet Lokale janë mbajtur në fund të vitit të kaluar, disa pagesa për trupat zgjedhore nuk ishte e mundur të realizoheshin brenda vitit 2017", është theksuar në njoftimin e KQZ-së.



# Shkollimi i të rinjve, i rëndësishëm për vendin

PRISHTINË, 23 KORRIK (ER) - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pritur të hënën në takim përfaqësuesit e Fondit Kosovar - Amerikan për Edukim (KAEF), të kryesuar nga Dale Pfeiffer, themelues i këtij fondi dhe udhëheqës i parë i USAID-it në Kosovë.

Kryeministri Haradinaj ka falënderuar përfaqësuesit e KAEF dhe ShBA-në për ndihmën që kanë dhënë për krijimin e mundësive për shkollimin e të rinjve kosovarë përmes bursave në nivelin master të studimeve në universitete më prestigjioze amerikane. "Jemi duke punuar me përkushtim për ngritjen e cilësisë në arsim në të gjitha nivelet, andaj ndihma juaj në ofrimin e mundësive për studentët tanë, që studimet e tyre t'i ndjekin në universitetet më të mira amerikane, do të jetë ndihmë e drejtpërdrejtë në forcimin e zhvillimit të gjithanshëm të vendit", ka deklaruar kryeministri Haradinaj.

Gjatë takimit Haradinaj ka theksuar se programet dhe bashkëpunimet e tilla janë të mirëseardhura për ngritjen e kualitetit në arsim dhe në të gjitha fushat, që do të ketë ndikim në zhvillimin ekonomik të vendit.

Ndërkaq përfaqësuesit e Fondit Kosovar - Amerikan për Edukim (KAEF) shprehën gatishmërinë e tyre që edhe në të ardhmen ta vazhdojnë bashkëpunimin e tyre në të mirë të shoqërisë në Kosovë.

KAEF deri tash ka mbështetur mbi 95 studentë kosovarë për studimet master në universitete të ndryshme amerikane.



Ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka prezantuar projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes financiare IPA 2017, pjesa e parë ndërmjet Kosovës dhe BE-së

# Ministrja Hoxha kërkon përshpejtimin e zbatimit të IPA-s 2017

Ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka kërkuar që me procedurë të përshpejtuar të miratohen dy ligjet, IPA 2017, pjesa e parë si dhe Marrëveshja me BE-në, Evropa për qytetarët. Në programin IPA 2017, pjesa e parë, përfshin 11 projekte të cilët do ta ndihmojnë përafrimin me legjislacionin e BE-së, të drejtat e njeriut, efiçiencën e energjisë, ekonominë digjitale, sigurinë ushqimore si dhe përkrahjen për lidhjen më të mirë të arsimit me tregun e punës dhe politikat sociale



EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 23 KORRIK - Ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka prezantuar të hënën para Komisionit Parlamentar për Integrim, projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes financiare IPA 2017, pjesa e parë ndërmjet Kosovës dhe BE-së. Ministrja Hoxha ka treguar se në kuadër të programit IPA 2017 Kosova ka përkrahje buxhetore sektoriale për menaxhimin e financave publike. "Programi është ndarë në dy pjesë, ku tani kemi vetëm pjesën e parë, ndërsa IPA 2017, pjesa e dytë, do të miratohet me një marrëveshje financiare ku ne përfitojmë mjete, por nuk kemi obligime financiare. Prandaj ratifikimi i saj do të kryhet nëpërmjet dekretimit nga presidenti", ka theksuar ministrja Hoxha, duke cekur se afati përfundimtar për hyrjen e saj në fuqi është data 31 dhjetor 2018.

Hoxha ka bërë me dije se nëse deri atëherë Kosova nuk e njofton BE-në se ka kryer të gjitha procedurat për hyrjen në fuqi të marrëveshjes financiare, duke përfshirë edhe ratifikimin në Kuvend si dhe më pas dekretimin nga presidenti dhe shpalljen në Gazetën Zyrtare, atëherë fondet e dhuruara nga BE-ja si pjesë e kësaj marrëveshjeje, në shumën prej 48 milionë eurosh anulohen në mënyrë automatike.

Kjo marrëveshje financiare rregullon zbatimin e programit IPA 2017, pjesa e parë, ku përfshin 11 projekte të cilat do ta ndihmojnë përafrimin me legjislacionin e BE-së, të drejtat e njeriut, efiçiencën e energjisë, ekonominë digjitale, sigurinë ushqimore si dhe përkrahjen për lidhjen më të mirë të arsimit me tregun e punës dhe politikat sociale.

Në tërësi programi konsiston në financimin e 48 milionë eurove nga ana e Bashkimit Evropian për Kosovën, ndërsa shuma totale e përfshirë është 49 milionë e 478 mijë euro, ku përfshihen edhe bashkëfinancimi nga ana e Kosovës në shumën prej 1 milion e 478 mijë eurosh për disa nga projektet (1 milion në fushën e energjisë dhe 0.45 milionë euro për fushën e arsimit, punësimit dhe çështjeve sociale, si dhe 23 mijë euro për programet e BE-së). Ministrja Hoxha ka pohuar se në kuadër të demokracisë dhe qeverisjes, që ka shumën totale prej 14.8 milionë eurosh, do të përkrahet procesi i integrimit evropian nëpërmjet ngritjes së kapaciteteve institucionale për hartimin dhe zbatimin e politikave dhe legjislacionit që do të transpozojë legjislacionin e BE-së në kuadër të legjislacionit të Kosovës. "Këtu përfshihen posaçërisht masat që do ta mundësojnë zbatimin e obligimeve që dalin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit dhe ka shumën prej 6 milionë eurosh. Ndërsa me 3 milionë euro, BE-ja do ta përkrahë financiarisht zbatimin e prioriteteve që dalin nga dialogu politik ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, e të cilat kontribuojnë në procesin e normalizimit si parakusht esencial në drejtim të integrimit evropian. Mbështetje do të ketë edhe për autoritetin e konkurrencës dhe ndihmën shtetërore me shumën prej tre milionë eurosh si asistencë teknike, si dhe për forcimin e sistemit të pronësisë intelektuale në Kosovë me shumë prej dy milionë eurosh", ka thënë ajo.

Hoxha ka theksuar se së fundmi do të përkrahet edhe qasja e Kosovës në programet e BE-së, në shumë prej 0.8 milionë eurosh. Shuma kryesore do të shkojë për një asistencë teknike për ta mbështetur qasjen e aplikuesve në kuadër të këtyre programeve, ndërsa një shumë e caktuar do të përdoret për ta kryer rimbursimin në masën 90 % të pagesës për qasje të Kosovës në katër programet e zgjedhura për vitin 2018: Evropa për qytetarët, Erasmus Plus, Evropa kreative dhe COSME.

Ministrja Hoxha ka shtuar se në kuadër të sundimit të ligjit dhe të drejtave fundamentale do të ketë përkrahje për institucionin e avokatit të popullit për ta forcuar këtë institucion me ekspertizën e nevojshme me shumë prej tre milionë eurosh. "Në kuadër të sektorit të energjisë, BE-ja parashihet ta financojë 10 milionë euro krijimin e fondit të efiçiencës së energjisë. Në kuadër të konkurrueshmërisë dhe inovacionit, do të ndahen tre milionë euro për ta përkrahur sektorin e teknologjisë së informimit dhe komunikimit. Në kuadër të bujqësisë dhe zhvillimit rural, do të përkrahet siguria dhe cilësia e ushqimit me investime që arrijnë në 5.2 milionë euro", ka deklaruar ministrja Hoxha, duke shtuar se për fushën e arsimit, punësimit dhe politikave sociale, përkrahja nga BE-ja do të mbërrijë në 12 milionë euro. "Në këtë fushë do të përkrahet rritja e arsimit dhe qasjes në arsim, duke ndihmuar infrastrukturën arsimore si dhe qasjen në tregun e punës nëpërmjet arsimit vokacional", është shprehur ajo.

Ministrja Hoxha ka pohuar se tenderimi dhe kontraktimi do të kryhen nga ana e Zyrës së BE-së në Kosovë e cila është autoritet kontraktues. Ministrja ka kërkuar që me procedurë të përshpejtuar të miratohen dy ligjet, IPA 2017, pjesa e parë si dhe Marrëveshja me BE-në, Evropa për qytetarët.

## 2018-a, vit i liberalizimit të vizave

Ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, është përgjigjur edhe ndaj pyetjeve të anëtarëve të Komisionit Parlamentar për Integrim lidhur me rekomandimin pozitiv për liberalizimin e vizave, të cilin e ka vlerësuar si sukses ngaqë janë përmbushur të gjitha kushtet e parapara. Hoxha ka dhënë shpjegime edhe për procedurat e mëtejme për këtë proces. Sipas ministres, pritet që ky vit të jetë vit i liberalizimit të vizave, procedurë që mund të realizohet. Pas rekomandimit pozitiv çështja shkon në shqyrtim te këshilli i ministrave dhe procedura e votimit me shumicë të kualifikuar, në Parlamentin Evropian.



# Daci takohet me avokatin e popullit, diskutojnë për bashkëpunim

PRISHTINË, 23 KORRIK (ER) - Kryetari i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës (ASHAK), akademik Nexhat Daci, ka pritur të hënën në takim Avokatin e Popullit, Hilmi Jasharin dhe zëvendësen Majlindë Sinani-Lulaj. Gjatë takimit u arrit te një konstatim i përbashkët se ka gatishmëri nga AShAK-u dhe Zyra e Avokatit të Popullit të punojnë së bashku për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave fundamentale duke u bazuar në konventat relevante ndërkombëtare. Udhëheqësit e të dy institucioneve janë zotuar të punojnë për rritjen e nivelit të bashkëpunimit ndërmjet tyre dhe promovimin e të drejtave fundamentale të njeriut si parakusht për funksionimin e shtetit të së drejtës dhe zhvillimin demokratik të vendit.

# Lluka: Kamenica, pjesë e projekteve të energjisë, ujërave dhe ekonomisë digjitale




PRISHTINË, 23 KORRIK (ER) - Komuna e Kamenicës do të përfshihet në projektet e rëndësishme që kanë të bëjnë me energjinë, ujërat dhe ekonominë digjitale, ka deklaruar të hënën ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdin Lluka. Këto komente kreu i MZhE-së i ka bërë gjatë vizitës që i ka bërë kësaj komune, ku është pritur nga kryetari Qëndron Kastrati.
Lluka në këtë vizitë u shoqërua edhe nga zëvendësministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, dhe deputeti i Kuvendit të Kosovës, Islam Pacolli. "Qeveria e Kosovës para dy javëve ka nënshkruar dy marrëveshje, një me Qeverinë Zvicerane për integrimin e fshatrave në sistem të ujësjellësit, ku nga ky projekt do të përfitojë edhe Komuna e Kamenicës si dhe një marrëveshje që kemi nënshkruar javën e kaluar me Bankën Botërore për digjitalizimin ekonomik të vendit, ideja e të cilit është t'i përfshijmë të gjitha fshatrat në sistemin me fibra optikë që u mundëson qasje në internet të shpejtë banorëve që janë më larg qytetit me qëllim të vetëpunësimit", ka thënë Lluka. Sipas tij, me rëndësi për Kamenicën është edhe trajtimi i ujërave të zeza, duke përfshirë Ranillugun, veçanërisht trajtimi i ujërave që vjen nga Miniera e Artanës, në mënyrë që qytetarët e Kamenicës mos ta kenë problem ujin e pijes.
"Gjatë këtij takimi u pajtuam që me përkrahje të donatorëve ta bëjmë studimin e fizibilitetit që i përfshin mundësitë për trajtimin e ujërave të zeza. Diskutuam edhe për mundësinë e investimeve në rrjetin aktual të ujësjellësit në Kamenicë, integrimin e fshatrave në ujësjellës, por edhe për ndërtimin e digave, të cilat parashihen të zhvillohen edhe me Strategjinë e Ujërave të Kosovës", është shprehur Lluka.
Nga ana e tij, kryetari i Kamenicës, Qëndron Kastrati, në emër të qytetarëve ka falënderuar ministrin Lluka për vizitën dhe gatishmërinë e tij për t'i çuar përpara bashkërisht projektet e kësaj komune që ndërlidhen edhe me MZhE-në.
Zëvendësministri i MMPH-së, Fatmir Matoshi dhe deputeti Islam Pacolli, premtuan mbështetje të pakursyer për Komunën e Kamenicës nga resorët që drejton AKR-ja, duke theksuar se vizita e tyre në këtë format tregon këtë gatishmëri.
Më pas ministri Lluka vizitoi edhe projektin energjetik Air Energy në fshatin Kikë, ku premtoi angazhim për krijimin e kushteve më të mira për investitorët. Lluka ka thënë se ky projekt është i rëndësishëm për arsye se Kosova duhet t'i përmbushë kriteret e Bashkimit Evropian për energji të ripërtëritshme, mirëpo edhe për ambientin, vendet e punës dhe aktivitetin ekonomik që gjeneron ky lloj biznesi.
I pari i MZhE-së ka bërë me dije se deri në fund të vitit pritet që në Kosovë të jenë funksionale rreth 80 megavat/h energji nga era. Kapaciteti instalues i projektit "Air Energy" aktualisht është 3.6 MGW me mundësi zgjerimi, ndërsa hyrja në operim pritet të nisë nga shtatori i këtij viti.

## Lirohet nga akuza ministri Valdrin Lluka

PRISHTINË, 23 KORRIK - Gjykata e Prishtinës ka shpallur aktgjykimin në rastin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, i akuzuar për konflikt të interesit.
Gjykata të hënën e ka liruar nga akuza ministrin Lluka. Në këtë proces gjyqësor akuzohej edhe Eliana Naka për të njëjtën vepër penale, e cila është shpallur fajtore.
Naka është dënuar me gjobë prej 7 000 eurosh, e cila, sipas kryetarit të trupit gjykues, Hamdi Ibrahimi, duhet të paguhet brenda 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Sipas aktakuzës, Lluka në cilësinë e zyrtarit në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë më 23 maj 2014 ka vepruar në kundërshtim me ligjin, ashtu që ka kërkuar që t'i fillojnë procedurat për zotimin e mjeteve prej 20 mijë eurosh për OJQ-në "Jakova Innovation Center", në të cilën OJQ ka qenë themeluesi, njëkohësisht ka pasur edhe pozitën e kryeshefit të Agjencisë për Promovimin e Investimeve. Në dhjetor të vitit të kaluar ministri Lluka ishte deklaruar i pafajshëm në aktakuzën e Prokurorisë.



# Në vjeshtë nis aksioni për pastrimin e Kosovës

PRISHTINË, 23 KORRIK (ER) - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka mbajtur të hënën një takim pune me ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, ministrin e Punëve të Brendshme, Bejtush Gashi, ministrin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, Rrustem Berisha, zëvendësministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Besim Demi, përfaqësuesin e Zjarrfikësve të Kosovës, Muharrem Beka dhe koordinatorin e iniciativës "Ta pastrojmë Kosovën", Luan Hasanaj, me të cilët ka biseduar rreth parapërgatitjeve për aksionin e përgjithshëm që do të zhvillohet për pastrimin e Kosovës, iniciativë kjo e ndërmarrë nga kryeministri Haradinaj.



Me këtë rast kryeministri Haradinaj ka thënë se kjo iniciativë për pastrimin e Kosovës duhet ta ketë vëmendjen e të gjitha institucioneve dhe të qytetarëve, pasi që edhe 19 vjet pas luftës ende nuk është ndërmarrë një aksion i përgjithshëm për ta bërë Kosovën më të bukur dhe më të pastër.
Kryeministri Haradinaj idenë për pastrimin e Kosovës e pati dhënë gjatë forumit të Nivelit të Lartë mbi Zhvillimin e Qëndrueshëm që i dedikohej mjedisit. "Gjendja e mjedisit në Kosovë nuk është e kënaqshme, prandaj është koha e fundit t'i kushtojmë vëmendjen e duhur ambientit, të krijojmë hapësira të gjelbra dhe ta ruajmë natyrën", është shprehur Haradinaj. Ai ka theksuar se në Kosovë është filluar të investohet në energji të ripërtëritshme dhe të pastër e cila do ta ruajë shëndetin e qytetarëve dhe ambientin nga ndotja, por se pastrimi gjeneral i Kosovës është nismë tejet e nevojshme dhe se tani është koha e fundit për të reaguar.
Ky takim me përfaqësuesit e institucioneve është i pari që do t'i paraprijë krijimit të një task force të përgjithshme dhe një plani operativ që do t'i përfshijë të gjithë aktorët institucionalë dhe përfaqësues nga organizatat joqeveritare për pastrimin gjeneral të Kosovës, i cili do të nisë në vjeshtë, për të vazhduar deri në fund të vitit.

# Korrjet në përfundim, bereqet pak

Shirat e shpeshta, dëmtimet nga breshëri dhe koha e vranët kanë qenë shkaktarët që këtë vit asnjë sipërfaqe me grurë nuk ka arritur t'i mbulojë shpenzimet e kombajnës as 50 për qind të çmimit të saj. "Në shumë sipërfaqe tashmë gruri është prishur nga lagështia. Rendimentet janë, për të mos thënë zero. Bile as që ia vlen të korret me gruri, sepse është prishur i tëri", ka thënë bujku Irfan Sadiku nga fshati Bujari i Komunës së Lipjanit

EPOKA E RE Ismail REXHEPI

PRISHTINË, 23 KORRIK - Për dallim nga vitet e kaluara, këtë verë nuk mbahet mend të ketë pasur korreshirje të grurit me rendimente më të ulëta. Asnjë sipërfaqe me grurë nuk ka arritur nga rendimenti i saj t'i mbulojë shpenzimet e kombajnës as 50 për qind të çmimit të saj.

Krejt ky rendiment i ulët është rrjedhojë e kushteve jo të mira atmosferike, në rend të parë të reshjeve të shiut të përditshme në periudhën kur kësaj kulture i duhej më së paku lagështia.

Beteja për bukën e motmotit tashmë veç po i afrohet fundit në mbarë vendin. "Edhe këto pak ara me grurë që kanë mbetur pa u korrur ende do të kalojnë ditë se autokombajna nuk mund të hyjë në to, sepse toka është ende në ujë. Pra, po të hyjë autokombajna ajo menjëherë do të mbesë në arë. Në shumë sipërfaqe tashmë gruri është prishur nga lagështia. Rendimentet janë, për të mos thënë zero. Bile as që ia vlen të korret më gruri, sepse është prishur i tëri", ka thënë bujku Irfan Sadiku nga fshati Bujari i Komunës së Lipjanit.

Te mulliri "Qali" afër Lipjanit disa bujq sillnin grurin pasi kishin bërë korrjen e tij. "Jam nga fshati Gadime e Ulët. Në këtë mulli kam sjellë grurin që sapo e korra", ka thënë bujku, Fatmir Tasholli. Ai ka treguar se nga 97 ari me grurë që ka korrur, ka marrë afër katër mijë kilogramë me grurë. Sipas Tashollit, nuk ishte një rendiment për t'u ankuar. Mirëpo, nga bisedat që morëm nga disa bujq të tjerë, ata theksuan se një hektar ka sjellë rendiment as pak e as më shumë se 2 000 kilogramë me grurë.

Pronarët e mullirit "Qali" kanë deklaruar për gazetën "Epoka e re" se sivjet ka shumë pak grurë që sjellin bujqit. Arsyeja është se rendimentet janë katastrofë të ulëta. Pra, sipas tyre, të rralla janë ato grunaja që për një hektar kanë dhënë 3 000 kilogramë grurë. Shkaktarë janë shirat e shpeshta, dëmtimet nga breshëri si dhe periudha e gjatë e kohës së vranët. Madje, sipas tyre, çfarë është edhe më e keqja, edhe ai grurë që merret është i cilësisë shumë të dobët.

Ankesa të ngjashme kishin edhe bujqit e fshatrave të komunave të tjera të Kosovës, si në Cërnillë të Ferizajt, Davidovc të Shtimes, në Gollak, në Keqekollë, ku në këtë fshat na foli për rendimente të ulëta bujku, Faik Ramadani. Po ashtu, ankesa kishin edhe bujqit e fshatit Koliq dhe Prapashticë të Komunës së Prishtinës. Edhe në fshatrat e rrafshit të kësaj komune rendimentet e grurit ishin jo të mira. Madje shumë sipërfaqe ishin dëmtuar nga breshëri, si në Besi dhe Prugovc.



# Mbi 94 për qind e investitorëve të huaj që ishin në Kosovë kanë ikur

PRISHTINË, 23 KORRIK (ER) - Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB) ka realizuar një studim hulumtues në Kosovë në lidhje me investitorët e huaj. Kryetari i AKB-së, Agim Shahini, ka thënë se një studim i tillë është zhvilluar për herë të parë në Kosovë. Ai ka theksuar se AKB-ja është e kënaqur që ka arritur ta realizojë këtë projekt me sukses. Pavarësisht prej kësaj, Shahini ka thënë se është i shqetësuar me të gjeturat e këtij studimi hulumtues. "Nga viti në vit ka pasur përmirësime të dukshme në politika fiskale, por jo të mjaftueshme. Kjo më së miri dëshmohet në të gjeturat e këtij studimi për të cilat investitorët kanë paraqitur vërejtjet e tyre në aspekt legjislativ dhe jolegjislativ. Vitin e kaluar nga të gjithë ata që kanë ardhur për ta vizituar Kosovën për mundësi të investimeve vetëm 2 për qind kanë mbetur këtu, 4 për qind janë duke e shqyrtuar mundësinë për të ikur, kurse 94 për qind janë deklaruar se nuk vijnë në Kosovë apo kanë gjetur mundësi më të mira në vendet e tjera", ka deklaruar kryetari i AKB-së, Agim Shahini.



# Kryetari i Junikut bën homazhe te varri i dëshmorit Sadik Ramë Ganijaj

JUNIK, 23 KORRIK (ER) - Kryetari i Komunës së Junikut, Agron Kuçi, me bashkëpunëtorë, ka bërë homazhe te varri i dëshmorit Sadik Ramë Ganijaj në fshatin Gjocaj. Kryetari Kuçi ka kërkuar nga familja Ganijaj dhe të gjitha familjet e dëshmorëve t'i rivarrosin të gjithë dëshmorët e rënë në një vend. "Duke u ngritur një lapidar i përbashkët që gjithmonë t'i nderojmë dhe t'i kujtojmë të bashkuar, ashtu siç ishin të bashkuar edhe në luftë, sepse të vetmin ideal kishin çlirimin e Kosovës", ka thënë Kuçi. Familja Ganijaj u pajtua me këtë ide të kryetarit Kuçi dhe shprehu gatishmërinë të bashkëpunojë në këtë drejtim.





# Vushtrria organizon shtatë ditë festë për mërgimtarët

VUSHTRRI, 23 KORRIK (ER) - Të hënën kanë filluar Ditët e Diasporës në Komunën e Vushtrrisë. "Nga sot e deri më 29 korrik ky institucion lokal do të organizojë ngjarje të shumta për nder të bashkatdhetarëve", është thënë në njoftimin e Komunës së Vushtrrisë. Gjatë këtyre ditëve do të ketë ekspozita, filma, orë letrare dhe muzikë, në kalanë e qytetit, dhe aktivitete me karakter sportiv e argëtues, si streetball e pingpong, në sheshin kryesor të qytetit. "Ditët e diasporës - ju jeni pjesë e atdheut", përmbyllen me një koncert të madh me valle në Bajgorë. Këto aktivitete janë bërë tradicionale, pasi komuna e Vushtrrisë ka disa vjet që i organizon gjatë verës.



# 'Drunj të pastër'

PRIZREN, 23 KORRIK (ER) - Në qytetin e Prizrenit të hënën është realizuar performanca publike "Drunj të pastër", e cila shërben si një thirrje e radhës për ruajtjen e ambientit në këtë qytet. Kjo performancë është mbajtur si rezultat i shqetësimeve të vazhdueshme të qytetarëve për dëmtimin e drunjve si pasojë e vendosjes së reklamave dhe shpalljeve në ta. "Duke qenë se Qendra Historike e Prizrenit në hulumtimet e mëparshme të realizuara nga EC Ma Ndryshe është evidentuar si një zonë me mungesë të hapësirave gjelbëruese atëherë edhe kujdesi ndaj këtyre drunjve të paktë duhet të jetë maksimal, pasi ata janë atribuesit kryesorë në pastërtinë e ajrit, hijen që krijojnë dhe janë pjesë e rëndësishme e peizazhit të qytetit të Prizrenit", është thënë në njoftimin e EC Ma Ndryshe. EC Ma Ndryshe edhe më parë ka reaguar mbi fenomenin e dëmtimit të drunjve në Qendrën Historike të Prizrenit nga shpimi e tyre si pasojë e reklamave dhe kishte prezantuar tabela model që do të shërbenin për vendosjen e materialeve të tilla promovuese apo njoftuese.

# Bordi i drejtorëve të Komunës së Mitrovicës kundërshton ndarjen e Kosovës

MITROVICË, 23 KORRIK (ER) - Në mbledhjen e rregullt të bordit të drejtorëve të Komunës së Mitrovicës, drejtuar nga kryetari i komunës, Agim Bahtiri, është biseduar për kundërshtimin e tendencave për ndarjen e Kosovës të shfaqura kohët e fundit për ndarjen e Mitrovicës dhe Kosovës. "Duhet të ketë mbarëvajtje normale dhe të qytetëruar e të qetë në mënyrë që pjesëmarrësit në takim të kenë mundësi ta shfaqin mendimin e tyre dhe t'i japin propozimet e tyre konkrete lidhur me këtë çështje", është thënë në këtë takim.



Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka ftuar përfaqësuesit e institucioneve, përfaqësuesit e subjekteve politike, përfaqësuesit e OJQ-ve, të asociacioneve të tjera, përfaqësuesit e komuniteteve fetare dhe institucioneve të tjera që të merren qëndrime të qarta se si duhet vepruar lidhur me këtë çështje me interes jetik për Mitrovicën, e Kosovën dhe për qytetarët në përgjithësi.

# Mbi 300 bashkatdhetarë të Gjilanit i bashkohen 'Ecjes së alpinistëve'

GJILAN, 23 KORRIK (ER) - Në kuadër të Muajit të Mërgatës, nën organizimin e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Gjilan dhe klubit alpin "Gjilani", të dielën është mbajtur aktiviteti "Ecja e alpinistëve". Nisja e alpinistëve është bërë nga qendra e qytetit, ka vazhduar për në Llovcë, për të përfunduar në pikën finale te Kalaja e Pogragjës. Drejtoresha e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Shpresë Hajdari,



është ndarë shumë e kënaqur me mbarëvajtjen e këtij aktiviteti, ndërkaq ka informuar se më se 300 bashkatdhetarë i janë bashkangjitur "Ecjes së alpinistëve".

# LIBERALIZIMI SI POLITIZIM DHE ILUZION

Fakti që "përmbushja e kritereve për liberalizim" u publikua në kohën kur filluan bisedimet për ndarjen e Kosovës, tregon më së miri se sa shumë është politizuar liberalizimi i vizave gjatë këtyre viteve, duke krijuar iluzione të kota te qytetarët



Ismet RASHITI

Ka vite që politika e Kosovës, kush më shumë e kush më pak, ka përdorur liberalizimin e vizave nëpër fushata elektorale si mjet për marrjen e votave. Propagandimi kaq i madh dhe me pompozitet ka krijuar iluzionin te qytetarët se me liberalizim të vizave do të zgjidhen të gjitha problemet. Në fakt, kjo e drejtë e pamohueshme e qytetarëve për lirinë e lëvizjes është penguar nga politika e papërgjegjshme, e cila nuk ka pasur vullnet ta luftojë korrupsionin, krimin e organizuar dhe rregullimin e pavarur të sistemit të drejtësisë. Dihet se kriteret për liberalizimin e vizave janë krejtësisht teknike, konkrete dhe të mundshme. Përjashtim në rastin e Kosovës ka bërë vetëm "kriteri i demarkacionit me Malin e Zi", i cili nuk është kërkuar nga asnjë shtet tjetër. Ky ka qenë një kriter krejtësisht politik, i sajuar më tepër nga politika e Kosovës për ta shtyrë këtë proces sa më tepër dhe për t'i realizuar disa objektiva politike në dëm të lëvizjes së lirë të qytetarëve.

Lëvizja e lirë e njerëzve është krejtësisht normale për një shtet normal dhe me qytetarë normalë të cilët, para së gjithash, e respektojnë shtetin e tyre. Me lëvizje të lirë nuk nënkuptohet zgjidhja e problemeve si me shkop magjik. Bredhja e kotë e kosovarëve nëpër metropolet evropiane nuk mund të konsiderohet kurrfarë fitore e askujt. Të paktë janë qytetarët e Kosovës që kanë mundësi ekonomike të shkojnë "turistë" në shtetet me standard të lartë.

Në kohën kur shtetet e zhvilluara po shkojnë në Planetin e Marsit, politika kosovare vazhdon ta quajë "fitore historike" lëvizjen e lirë që është krejt normale për një vend të pavarur në zemër të Evropës.

Mënyra se si është propaganduar liberalizimi i vizave nga politika, është krejtësisht e gabuar dhe me pasoja të mëdha për të ardhmen e Kosovës. Në fakt, në këtë mënyrë është krijuar një eufori e paparë te qytetarët. Një pjesë e madhe prej tyre kanë iluzionin se ka ardhur dita e ikjes nga Kosova dhe vendosja në një shtet tjetër evropian, kryesisht në Zvicër, Gjermani apo shtetet Skandinave, aty ku ka zhvillim më të madh ekonomik, ku shpresohet të jetohet më mirë dhe mundësisht pa punë. Përgjatë një dekade, sa është folur e përfolur deri në monotoni për liberalizimin, asnjëherë nuk është shpjeguar drejt nga politika, rëndësia, të mirat dhe pasojat që mund t'i ketë liberalizimi në mënyrë që qytetarët ta kuptojnë drejt, pa emocione dhe pa shpresa të mëdha për ndryshimin e jetës së tyre.

Hipokrizia më e madhe e të gjitha qeverive, së paku nga shpallja e pavarësisë, ka qenë kur në njërën anë gjoja bënin përpjekje për përmbushjen e kritereve për liberalizim, në anën tjetër thellonin korrupsionin e nivelit të lartë, nuk merreshin me luftimin e kriminalitetit dhe përditë e më tepër vetë të "mëdhenjtë" ndërhynin në sistemin e drejtësisë. Në këtë rrafsh qytetarët gjithnjë kanë qenë viktimë e hipokrizive dhe lojërave politike të krerëve institucionalë.

Fakti që "përmbushja e kritereve për liberalizim" u publikua në kohën kur filluan bisedimet për ndarjen e Kosovës, tregon më së miri se sa shumë është politizuar liberalizimi i vizave gjatë këtyre viteve, duke krijuar iluzione të kota te qytetarët që të mos e ndiejnë dhimbjen e prerjes së trojeve shqiptare në bisedimet e fundit Kosovë - Serbi.

Nëse liberalizimi bëhet në këtë çaste kaotike politike për ndarjen e Kosovës, bashkë me iluzionet e qytetarëve, pasojat do të jenë shumë të mëdha, sidomos për zbrazjen e Kosovës në mënyrë të pakontrolluar. Kjo do të jetë një barrë e rëndë për mërgatën shqiptare, e cila do të "detyrohet të mbajë parazitë dhe mysafirë" të panevojshëm të cilët do të bien viktimë e iluzioneve artificiale të krijuara nga politika amatore dhe krejtësisht e papërgjegjshme.

Gjëja më e keqe që mund të ndodhë është lidhja e liberalizimit me prapaskenat e bisedimeve të fundit të cilat do ta zgjasin për një kohë të gjatë lëvizjen e lirë dhe Kosovën patjetër do ta fusin në rrugë pa krye.

# Parkingu nëntokësor në kryeqytet do të kushtojë 15 milionë euro




PRISHTINË, 23 KORRIK (ER) - Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë ka organizuar aktivitetin e radhës me kryetarin e Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, me qëllim të njoftimit të bizneseve anëtare të Odës Amerikane me planet e komunës në lidhje me zhvillimin e qytetit, si dhe me të arriturat e deritanishme në sektorë të ndryshëm të ekonomisë.

Në adresimin e tij ndaj përfaqësuesve të bizneseve prezentë, Shpend Ahmeti ka theksuar se Komuna e Prishtinës është bërë iniciatore si dhe zbatuese e projekteve më të ndryshme të cilat kanë për qëllim përmirësimin e aspektit social dhe atij ligjor. Ahmeti theks të veçantë i ka kushtuar projektit për parkingun nëntokësor në vlerë prej 12 deri në 15 milionë euro, i cili do të zhvillohet si rezultat i partneritetit publiko-privat. Ai ka njoftuar se ky projekt, përveçse e forcon bashkëpunimin me sektorin privat, ndikon drejtpërdrejt edhe në zvogëlimin e numrit të automjeteve të cilat qarkullojnë në brendësi të qytetit të cilat, përveçse ndikojnë në ambient, edhe u pamundësojnë qytetarëve qarkullimin e lirë në këmbë.

Krahas investimeve në infrastrukturë, Ahmeti ka njoftuar të pranishmit me planet kryesore të cilat janë në fokus për tre vjetët e ardhshëm që përfshijnë zhvillimin e hartës zonale e cila parasheh krijimin e një mjedisi më të favorshëm për zhvillim të qytetit, zhvillimin e mëtejshëm të sektorit të shërbimeve si bartës i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik, si dhe ndërtimin e pesë (5) shkollave fillore në lagje të ndryshme në Prishtinë për të cilat infrastruktura fizike do të zhvillohet në konceptin e partneriteteve publiko-private.

Ahmeti ka njoftuar se ngritja e kapaciteteve në sektorin e shërbimeve është e domosdoshme duke marrë parasysh rritjen e lartë të kërkesës për shërbime. Në lidhje me aspektin ligjor, Ahmeti ka theksuar nevojën për ndërmarrjen e hapave më konkretë për mbajtjen e rendit, ku ka përmendur edhe iniciativën për ta konsideruar monitorimin e komunikacionit përmes kamerave dhe pajisjeve të tjera të cilat do t'i pamundësonin parkimet ilegale, si dhe vozitjen e automjeteve me shpejtësi mbi normat e lejuara.

EKREM BARDHA, SHQIPTARO-AMERIKANI QË LOBOI AQ SHUMË PËR LIRINË DHE PAVARË

# Ekrem Bardha në vitin 1986 fitoi b

- Shqiptari që takoi gjashtë presidentë amerikanë, sekretarë shteti, senatorë, kongresmenë, ambasadorë... U arratis nga Shqipëria, por kurrë dheun, vendin e vet, nuk e tradhtoi. Kosova ishte zemra e tij.



**Shkruan: Ferdinand SAMARXHI,**
*Fitues i Antenës së Artë Mjeshtër i Madh*

*- Zoti Bardha, ju jeni organizator i shumë protestave për çështjen shqiptare. Kur erdhi Mehmet Shehu në OKB ju dhe të tjerët organizuat një protestë të madhe kundër tij. Paradoks, ju lutem ndani me ne, çfarë ndodhi me protestën tuaj?*

**Ekrem Bardha:** Më 12 tetor 1960 në Nju Jork erdhi kryeministri shqiptar, Mehmet Shehu. Mërgata politike organizoi përpara selisë së OKB-së një demonstratë të fuqishme, në të cilën hidhte parulla kundër kryeministrit komunist, Mehmet Shehu dhe mungesës së lirisë në Shqipërinë komuniste. Ajo ditë, 12 tetor 1960, do të mbetet dita e lartësimit të identitetit tonë kombëtar, dinjitetit e krenarisë kombëtare, në të gjithë historinë e diasporës. Rruga, midis të "First Avenue" & "49 Street", u gjakos me gjak shqiptari.

Rruga ku diaspora shqiptare, patriotët, atdhetarët e antikomunistët, që kishin dalë ato ditë kundër kryeministrit komunist shqiptar, Mehmet Shehut, e harruan atë dhe spontanisht të motivuar nga një provokacion i rëndë i grupeve të diasporës greke, për disa orë u përleshën fizikisht me diasporën greke, që kishte dalë të protestonte, me parulla dhe flamuj grekë që kërkonin nga Kombet e Bashkuara, njohjen e të ashtuquajturit Vorio Epir - Epiri i Veriut. Ata kishin ngritur zërin duke shfrytëzuar pjesëmarrjen e Mehmet Shehut dhe liderëve nga e gjithë bota, duke kërkuar, sipas tyre, të ashtuquajturat të "drejtat" e nëpërkëmbura të minoritetit grek, në Shqipëri, zhdukjen e çështjes çame, dhe mbajtjen në fuqi të Ligjit të Luftës dhe kërkonin që ta merrnin, sipas tyre, gjithë Jugun e Shqipërisë, me pretendime të egra shoviniste deri në Shkumbin. Diaspora shqiptare ndodhej në të njëjtin shesh për të protestuar kundër regjimit komunist që kishte izoluar Shqipërinë dhe dënonte me mijëra shqiptarë për fjalën e lirë. Përplasja filloi "duke u goditur fillimisht në distancë, ku në mes qëndronte një rresht me policë amerikanë, ndërsa protestuesit hidhnin mjete të forta dhe hedhin parulla fyese e ofenduese" si nga protestuesit shqiptarë dhe turma greke që ishte më e organizuar dhe e përgatitur për t'iu kundërvënë shqiptarëve, duke menduar se "edhe ata do t'i bashkoheshin atyre meqenëse kishte ardhur kryeministri komunist". Kjo situatë vazhdoi për disa orë derisa përleshja u vu nën kontrollin e policisë njujorkeze, e cila kërkoi që protestuesit e të dyja palëve të mos afroheshin shumë afër njëri-tjetrit.

Demonstratën dhe përleshjen e përgjakshme e kanë ndjekur për herë të parë gazetarët e gazetave dhe radiove më të mëdha amerikane. Të nesërmen ishte hera e parë që shqiptarët "pushtuan" lajmet e asaj dite, në faqet e para të gazetave më të njohura të Nju Jorkut. Të gjitha gazetat, radiot më të mëdha amerikane dhe më prestigjiozet e botës, e pasqyruan ngjarjen me tituj të mëdhenj dhe në faqe të parë. Disa prej këtyre mediumeve këtë ngjarje e shoqëruan edhe me fotografi se çfarë kishte ndodhur dhe se si kishte ndodhur. "New York Times", "USA Today", "Washington Post", "St Petersburg (FL) Times", "Associated Press", "Denver Post", "Chicago Tribune",


...mpt By UDBA
...Who Cooperate With
...s On UDBA "Hit" List

Ekrem Bardha and his daughter Donika, between former President Gerald Ford and Michigan Governor Milliken on the right.

Ekrem Bardha me presidentin e ShBA-së, Gerlad Ford

"Christian Science Monitor" e të tjera në faqe të parë pasqyruan demonstratën dhe ngjarjen, duke e pasqyruar atë si lajm kryesor të asaj dite. Disa prej tyre dolën me tituj të tillë si: "Gjakoset rruga përballë Kombeve të Bashkuara". Në Nju Jork hapet "lufta" midis Greqisë dhe Shqipërisë" - "nacionalistët dhe antikomunistët shqiptarë në Amerikë, për hir të Shqipërisë, dalin e 'mbrojnë' udhëheqësin komunist kryeministrin Mehmet Shehu", "për hir të kombit të tyre, emigrantët politikë shqiptarë për pak e harruan udhëheqësin komunist". "Shqiptarët, treguan se janë nacionalistë të mëdhenj" e shumë e shumë tituj të tjerë të kësaj ngjarje.

Ky është një shembull që të bën të ndihesh krenar për ndjenjën e atdhedashurisë që kanë shqiptarët kudo në botë. Gjithashtu, është edhe një mesazh për brezat e rinj, që regjimet apo qeveritë shkojnë e vijnë, por atdheu mbetet një për të gjithë shqiptarët. Nëse ka diçka që më ka ndjekur gjatë gjithë jetës sime është pikërisht dashuria për atdheun, për vendin tim, edhe në kohën e fatkeqësive, edhe në atë të suksesit.

*Z. Bardha, biografia juaj është mjaft e pasur për çështjen kombëtare. Duke qenë larg vendit tuaj, si u bëtë ju edhe kosovar?*

**Ekrem Bardha:** Në vitin 1966 unë shkova në Paris dhe vendosëm të takoheshim me prof. Abaz Ermenjin, emër i madh në historinë e kombit. Takimi u bë në një restorant në qendër të Parisit. Ishte një takim shumë emocionues për mua. I tregova më pak fjalë historinë time dhe të familjes, dhe i hapa zemrën për shqetësimin tim dhe të të gjithë shqiptarëve në mërgim se si duhet ta zgjidhnim hallin e madh që na kishte rënë, Shqipërinë komuniste. Të organizohemi dhe të punojmë me të gjitha fuqitë tona për ta rrëzuar regjimin komunist, me qëllimin e mirë për ta bërë Shqipërinë një vend demokratik dhe të zhvilluar, ky ishte edhe qëllimi i takimit me profesorin e nderuar. Por, për çudi, profesor Ermenji, filloi të më fliste me pasion për çështjen e Kosovës, duke e quajtur mbetjen e saj jashtë territorit të Shqipërisë, "një tragjedi kombëtare".



Profesori vazhdonte të shpjegonte me fakte konkrete tragjedinë e ndarjes së trevave shqiptare nga Konferenca e Londrës, për të ardhur deri në ditët tona, duke përshkruar gjendjen e mjeruar të kosovarëve nën regjimin e Titos. Nuk po kuptoja me të vërtetë se pse ishte gjithë ai zell i profesorit të nderuar për Kosovën, kur ne kishim problemin e Shqipërisë nën sundimin komunist, një plagë të hapur që duhej mbyllur. I kërkoj ndjesë dhe leje njëkohësisht, nëse mund ta ndërprisja profesorin për një moment dhe i them: "Profesor, me gjithë dhembjen që ndiej për ndarjen e Kosovës dhe për vuajtjet e vëllezërve kosovarë, dua t'ju them se këtë takim e kërkova që të bisedojmë për problemet e Shqipërisë, për hallin e madh që na ka zënë, për shembjen që duhet t'i bëjmë regjimit komunist dhe ndërtimin e një sistemi demokratik. Si një lider i mërgatës politike shqiptare, unë po pres nga ju të më thoni dhe të më jepni shpresë se si do të ndërhyjmë në Shqipëri, për të rrëzuar atë sistem diktatorial, që më detyroi mua dhe mijëra shqiptarë të tjerë të braktisnim vendin tonë nga persekutimi komunist…". Profesor Ermenji më dëgjoi me qetësi duke kuptuar shqetësimin tim dhe më tha: "Megjithëse që të dy jemi kundër sistemit komunist, përsëri Shqipërinë e kemi shtet, kurse problemi më i madh kombëtar ende i pazgjidhur. Fjalët e tij më qartësuan te fakti se Kosova ishte kështjella që duhet të merrnim ne




Demonstrata e diasporës shqiptare në ShBA. Nga e djathta Ekrem Bardha

ËSINË E KOSOVËS (2)

# etejën e parë kundër Jugosllavisë



shqiptarët kudo që ishim në botë, për ta bërë shtet të pavarur dhe të lirë nga zgjedha titiste".

*Çështja Ivezaj ishte prologu, fillimi i demaskimit të regjimit çnjerëzor të Jugosllavisë. Në vitin 1996 ju dhe bashkatdhetarët e tjerë e themeluat lobin shqiptar në Uashington?*

**Ekrem Bardha:** Fitorja e parë e diasporës shqiptare në ShBA ndaj ish-Jugosllavisë do të shënohej në vitin 1986, kur i rrezikoi shtetit jugosllav statusin e vendit më të favorizuar në Amerikë. Por, përpjekjet e diasporës se Amerikës kishin vite që kishin filluar me mënyrat nga më të ndryshmet. Do të përqendrohem tek rasti që për herë të parë në Kongresin Amerikan denoncohet me dëshmi dhe fakte konkrete, keqtrajtimet e shqiptarëve në Jugosllavi. Ishte viti 1986 kur komuniteti shqiptar në Amerikë u trondit nga arrestimi i shqiptaro-amerikanit Pjetër Ivezaj nga Malësia e Madhe. Ai kishte shkuar për pushime në vendlindjen e tij dhe autoritetet jugosllave i paraqiten disa fotografi, si prove fajësie, që tregonin pjesëmarrjen në demonstratat e organizuara pesë vjet më parë, më 1981, në Uashington. Gjykata e dënoi me shtatë vjet burg. Komuniteti shqiptar në Miçigan u vu menjëherë në lëvizje. Për këtë shkelje të rëndë të të drejtave lajmërova kongresistin Broomfield, i cili jo vetëm e mori seriozisht këtë çështje, por menjëherë e vuri në rend të ditës në Kongresin Amerikan. Ky ishte hapi i parë, nga ku do të niste një kalvar i madh i përpjekjeve të diasporës për t'i bindur diplomatët amerikanë, që Jugosllavia është shteti që përdor gjenocid te shqiptarët. Fjala e kongresistit Broomfield krijoi reagime në Kongres. Anëtarë të tjerë të Kongresit Amerikan nisën të interesohen rreth rastit në fjalë dhe të njihnin një tjetër Jugosllavi, ndryshe nga ajo që zyrtarët e atij vendi kishin propaganduar, për sa iu takon të drejtave të shqiptarëve. Përpjekja e diasporës sapo kishte nisur t'i jepte efektet e para. Me këmbënguljen e William Broomfield u organizuan dy seanca të veçanta për dëgjim dëshmitarësh në nënkomisionin e Kongresit për të Drejtat e Njeriut të kryesuar nga kongresisti Gus Yatron. Seancat u mbajtën më 2 dhe 8 tetor 1986.

Të gjitha materialet u botuan në një broshurë me titullin "Persekutimi i minoritetit shqiptar në Jugosllavi", e cila përbën një dokument me vlerë historike, sepse për herë të parë Kongresi Amerikan ngriti akuzë ndaj Jugosllavisë, shtetit me statusin e vendit të favorizuar, për shkeljen e të drejtave njerëzore dhe qytetare në atë vend. Kongresisti William Broomfield më kërkoi që unë të dëshmoja në Kongresin Amerikan, kështu më 8 tetor 1986 dëshmova përpara Kongresit Amerikan për shkeljet flagrante, për keqtrajtimet që u bëheshin shqiptarëve në Jugosllavi.

Kongresisti William Broomfield bindi kongresistët e tjerë se ndaj Jugosllavisë duhej hartuar një peticion, ku do të kërkoheshin sanksione të forta ndaj këtij shteti. Brenda pak orësh, 150 kongresistë nënshkruan peticionin ku kërkohej lirimi i shqiptaro-amerikanit, në të kundërt ata do ta propozonin heqjen e statusit të vendit të favorizuar për Jugosllavinë me ShBA-në dhe ndërprerjen e marrëdhënieve diplomatike mes dy vendeve. Ultimatumi i kongresit krijoi një reagim të menjëhershëm në Jugosllavi. Qeveria jugosllave, e trembur nga sanksionet, mori vendimin që ta lirojë menjëherë nga burgu bashkatdhetarin tonë dhe qeveria jugosllave i kërkoi falje Shtëpisë së Bardhë për incidentin dhe e siguronte se nuk do të përsëriteshin më raste të tilla.

Ne shqiptarët e Amerikës kishim fituar një betejë të madhe dhe nga ai çast, faktori shqiptar në Amerikë nisi të merrej seriozisht në konsideratë, të ishte i besueshëm për çështjet që ngrinte.

*Çfarë ishte NAAC-u? Përse e themeluat ju?*

**Ekrem Bardha:** Ishte ideja e kongresistit Broomfield që ne shqiptarët, më shumë prani tashmë në ShBA, të krijonim një lob siç kishin edhe komunitetet e tjera në ShBA, grekët apo hebrenjtë, sepse duke përdorur një shprehje shqiptare, ai tha se ju jeni si "tufa pa çoban", prandaj duhet të organizoheni përmes një këshilli. Në vitin 1995 bisedova me ambasadorin William Ryerson, ish-ambasadori i parë amerikan në Tiranë, pas rënies së regjimit komunist në Shqipëri. Ambasadori Ryerson ishte një lobist i madh i çështjes shqiptare në Shqipëri dhe Kosovë. Ishin momente kur situata në Kosovë po përkeqësohej nga politika shfarosëse e Milloshevigit. Ambasadori Ryerson e njihte fare mirë situatën në Kosovë, pasi kishte qenë konsull amerikan në Prishtinë dhe e përforcoi idenë time për krijimin e një organizate jofitimprurëse, pra të një lobi që do të punonte vullnetarisht për ta sensibilizuar politikën amerikane mbi problemet serioze të çështjes së Kosovës. Tashmë politika amerikane ishte pak a shumë e familjarizuar me politikën diskriminuese të Jugosllavisë, pasi nuk kishte kaluar shumë kohë nga ultimatumi që kishte marrë prej Kongresit Amerikan. Por, sidoqoftë, duhej edhe më shumë përpjekje nga diaspora shqiptare e Amerikës, pasi situata po rëndohej dhe politika e Milloshevigit po bëhej më agresive dhe për këtë duhej një ndërhyrje më e organizuar në politikën dhe diplomacinë amerikane nga faktori shqiptar.

**(Vijon)**


The Oldest Albanian Newspaper In The World

In English Dielli and Albanian

BULK RATE
U.S. POSTAGE
PAID
Permit No. 3
Boston, MA

1909 1986

Vol. 77 No. 17 Boston, Mass. U.S.A. October 16, 1986 77th Year

EKREM BARDHA AND SENATOR BLOOMFIELD

THE HONORABLE WILLIAM S. BLOOMFIELD (R-MICHIGAN) STATEMENT BEFORE THE SUBCOMMITTEE ON HUMAN RIGHTS AND INTERNATIONAL ORGANIZATIONS

THE ILLEGAL DETENTION OF PJETER IVESZJ, A U.S. CITIZEN IMPRISONED IN YUGOSLAVIA
THURSDAY, OCTOBER 2, 1986
STATEMENT ON PJETER IVEZAJ BEFORE

*Pasqyrimi i medieve amerikane nga raportimi i Ekrem Bardhës në Kongresin Amerikan. Në fotografi Ekrem Bardha dhe kongresisti William Broomfield*


Testifying before Congress on the Ivezaj case. Congressman William Broomfield, Ekrem Bardha, Donika Bardha, Dr. Tako Bacaj, Gjon Lulgjuraj, Sejdi Bitici *(from right to left)*.


William Broomfield and Ekrem Bardha.

*Ekrem Bardha duke denoncuar çështjen Ivezaj në takim me kongresistin William Broomfield*

## Kryebashkiaku i Torontos reagon ndaj sulmit




TORONTO, 23 KORRIK - Kryetari i Bashkisë së Torontos, Xhon Tori, e quajti akt dhune prej frikacakësh incidentin e së dielës në mbrëmje ku, sipas policisë, një njeri i armatosur shtiu ndaj 14 vetave duke vrarë dy prej tyre.
Incidenti përfundoi me vdekjen e vetë personit që shtiu ndaj qytetarëve në lagjen Greektown të Torontos. Shefi i policisë tha se me të dyshuarin pati një "shkëmbim zjarri". Ai tha se hetuesit po punojnë për ta përcaktuar motivin e ngjarjes dhe se deri tani asnjë pistë nuk është përjashtuar. Kryetari i Bashkisë Tory u tha gazetarëve se qyteti ka një problem me armët që të mund të bien lehtë në duart e shumë njerëzve.

# Njoftimi mbi vizitën e Putinit në ShBA shtang Uashingtonin

Si për t'i hedhur benzinë zjarrit, po planifikohet një tjetër takim Trump - Putin, këtë herë në tokën amerikane. Lajmi kapi në befasi edhe vetë shefin e zbulimit amerikan Dan Coats



UASHINGTON, 23 KORRIK - Pa u shuar ende vala e kritikave të gjera ndaj presidentit Trump lidhur me takimin e nivelit të lartë në Helsinki, Uashingtoni vazhdon të gëlojë nga debatet pas njoftimit të Shtëpisë së Bardhë, se presidenti rus Vladimir Putin do t'i vizitojë Shtetet e Bashkuara gjatë këtij viti.
Si për t'i hedhur benzinë zjarrit, po planifikohet një tjetër takim Trump - Putin, këtë herë në tokën amerikane. Lajmi kapi në befasi edhe vetë shefin e zbulimit amerikan Dan Coats.
Një vizitë zyrtare në Uashington është një nder, që pak ligjvënës amerikanë të secilës parti besojnë se Vladimir Putini e meriton. Por Trumpi po kundërpërgjigjet në mesin e kritikave të forta për deklaratat e tij gjithnjë të ndryshme lidhur me ndërhyrjen ruse në zgjedhjet presidenciale amerikane të vitit 2016. Nëpërmjet një postimi në "Twitter" të dielën presidenti këmbënguli se ai kishte pasur "një takim të jashtëzakonshëm me Putinin" në Helsinki dhe akuzoi ato që i quajti media të rreme që po e nënvlerësojnë, duke e quajtur këtë, një gjë të keqe për vendin.
Por demokratët nuk pajtohen. "Bisedimet në Helsinki ishin të frytshme, por për Vladimir Putinin realiteti është se ne nuk kemi asnjë ide se për çfarë ky president, presidenti ynë, ka rënë dakord. Ne dimë që pas largimit nga takimi dhe kthimit në atdhe, presidenti reduktoi angazhimin tonë ndaj sigurisë kolektive në kuadër të NATO-s. A ishte dhe kjo një temë e diskutimit? A u ngre çështja e Malit të Zi?", thotë ligjvënësi demokrat Adam Schiff.
Ndërkohë, Qeveria ruse i konsideroi polemikat si një grindje e vogël partiake amerikane. "Rusia dhe marrëdhëniet rusoamerikane u bënë peng i luftës së brendshme politike mes demokratëve dhe republikanëve. Për fat të keq, histeria anti-ruse apo ruso-fobia nuk po tregon shenja të rënies në Shtetet e Bashkuara. Në një moment, mendova se niveli i retorikës anti-ruse ra, por nuk po ndalet. Dhe mendoj se nuk do të ndalet deri në zgjedhjet amerikane të nëntorit", thotë Anatoli Antonov ambasadori rus në Shtetet e Bashkuara.
Në fund të javës së kaluar, Shtëpia e Bardhë u distancua nga një propozim i Rusisë që u jepte mundësinë Shteteve të Bashkuara dhe Rusisë, të merrnin në pyetje shtetasit e njëri-tjetrit. "Nënshtrimi i diplomatëve ndaj Putinit? Ky është abuzim me pushtetin", tha udhëheqësja e pakicës demokrate Nancy Pelosi. "Naive dhe absurde. Nuk ekziston sundimi i ligjit në Rusi, vetëm sundimi i Putinit", thotë senatori republikan Lindsey Graham.
Senati miratoi njëzëri një rezolutë që kundërshtonte marrjen në pyetje nga Qeveria ruse të ish-zyrtarëve amerikanë apo atyre në detyrë, duke i dërguar një mesazh të fortë, të mbështetur nga të dyja palët, Shtëpisë së Bardhë.

# Lavrovi dhe Netanyahu bisedojnë për praninë iraniane në Siri



JERUSALEM, 23 KORRIK - Ministri i Jashtëm i Rusisë, Sergey Lavrov, u takua në Jerusalem me kryeministrin izraelit Benjamin Netanyahu, me të cilin bisedoi për praninë iraniane në Siri. Netanyahu më herët ka njoftuar se gjatë takimit me presidentin rus, Vladimir Putin i ka kërkuar atij të takohet me një delegacion të lartë rus, përfshirë edhe shefin e Ushtrisë ruse, gjeneralin Valery Gerasimov, raporton AP.
Netanyahu ka thënë se aty do të bisedohet për zhvillimet rajonale dhe në rend të parë për situatën në Siri. Kryeministri izraelit ka thënë se do ta përsërisë qëndrimin e vendit të tij se pret nga presidenti sirian, Bashar Al-Assad dhe aleatët e tij, që mbështeten nga Irani, të respektojnë një marrëveshje të vitit 1974, për një zonë të demilitarizuar përgjatë kufirit mes dy shteteve, duke shtuar se Izraeli do të vazhdojë ta kundërshtojë krijimin e një pranie të përhershme ushtarake të Iranit në Siri.
Shqetësimi kryesor i Izraelit është t'i mbajë larg kufijve të vet forcat që mbështeten nga Irani. Rusia, në anën tjetër, ka paralajmëruar se nuk është realiste që të pritet një tërheqje e plotë e Iranit nga Siria.
Takimi i së hënës në mes të Lavrovit dhe Netanyahut vjen dy javë pasi kryeministri izraelit bisedoi në Moskë me Putinin për Sirinë dhe Iranin.

## Incidenti me truprojën, Macroni urdhëron riorganizim të stafit



PARIS, 23 KORRIK - Presidenti i Francës, Emmanuel Macron, urdhëroi ndryshime në staf, pas shfaqjes së një videoje që tregonte ndihmësin e tij duke rrahur një protestues. I përballur me presion në rritje, Macroni mblodhi të dielën disa ministra për ta diskutuar çështjen.
Alexandre Benalla, i cili ka qenë truprojë kryesore e Macronit, është parë duke tërhequr zvarrë një grua dhe më pas duke rrahur një burrë gjatë protestave për Ditën e Majit në Paris. Ai është akuzuar për dhunë në grup dhe për veshjen e një simboli të policisë në mënyrë të paligjshme. Benalla është shkarkuar të premten. Një zyrtar tha se Macroni e ka përshkruar incidentin si "të papranueshëm" dhe se ka premtuar se nuk do të kalojë pa u ndëshkuar.

# Rihanna rikthehet me dy albume



Këngëtarja e famshme Rihanna i ka munguar skenës botërore për një kohë të gjatë, por duket se tashmë pritja ka marrë fund dhe ajo do të kthehet me dy albume. Rihanna dhe stafi i saj janë duke kërkuar mes 500 këngëve nga producentë të ndryshëm për të përzgjedhur 10 prej tyre që do t'ia vlejnë, ndërsa projekti tjetër flitet të jetë i zhanrit pop.

# Emily Ratajkowski në krahë të bashkëshortit



Këtë herë Emily Ratajkowski është shfaqur në krahë të bashkëshortit të saj. Modeluesja 27-vjeçare po shijon pushimet në Miami në Florida dhe si gjithmonë ka mahnitur me paraqitjen e saj. Veshur me bikini ngjyrë mente ajo është fotografuar teksa përqafonte të shoqin, ndërkohë ky i fundit i mbante duart te të pasmet e modelueses. Ata dukeshin mjaft të lumtur në krah të njëri-tjetrit.



# Nicole Scherzinger shijon pushimet në Saint Tropez

Ata janë në lidhje gjatë tre vjetëve të fundit dhe duket se romanca mes tyre nuk po zbehet. Nicole Scherzinger dhe i dashuri i saj Grigor Dimitrov dukeshin si dy zogj të dashuruar përderisa po shijonin rrezet e diellit dhe detin. Dyshja po kalojnë disa ditë pushimi në plazhet e Saint Tropez. Këngëtarja shfaqi fizikun e saj fantastik, e veshur me bikine të bardha.

# Pushohet nga puna regjisori i "Guardian of the Galaxy"

"Disney" ka larguar nga puna regjisorin e "Guardians of the Galaxy Vol.3", James Gunn, pasi një numër i postimeve ofenduese të tij u shfaqen nëpër rrjetet sociale. Regjisori amerikan ka kërkuar falje pasi u shfaqën disa shkrime të tij në "Twitter", ku përmendej pedofilia dhe përdhunimi. Megjithatë, kreu i "Walt Disney Studios", Alan Horn, ka bërë me dije largimin e tij në fund të javës.






Autor: Gazmend Morina - BENI




- AKTORI AMERIKAN NË FOTO 1
- KAFSHË E VOGËL HELMUESE ME NGJYRË TË ZEZË (shq.)
- NDËRMARRJE E MADHE INDUSTRIALE E MEKANIZUAR (shq.)
- PAJTUESHMËRI (krah.)
- SHKOJ, ECI (bised.)
- DY BASHKËTINGËLLORE
- INDIANA
- DHËNIA E NJË ÇMIMI TË LARTË
- I PËRPIKTË, I SAKTË; I PAGABIM
- KËNGËTARJA DHE AKTORJA BRITANIKE NË FOTO 2
- BIMË BARISHTORE NJËVJEÇARE ME KOKRRAT E SË CILËS BËJMË PILAF (shq.)
- BASHKËTINGËLLORE / SUPER MODELJA SPANJOLLE ...... PEREZ
- NËNNDARJE E NJË KODI A E NJË RREGULLOREJE (shq.)
- BASHKË, TOK / RRUZULLI I TOKËS
- VËLLAI I MADH
- MODELJA & AKTORJA ... RAFAELI / BRAGA, AKADEMICA
- RENS ISTVUD
- VEGËL MUZIKORE ME FRYMË / ARKIVI I FILMAVE
- EPOKA E RE
- PEMË E VENDEVE TË NGROHTA
- GADISHULL NË EVROPË
- RRJETËZA E SYRIT
- INTERNATIONAL LEADERSHIP ASSOCIATION
- BASHKËTINGËLLORE / TROYES
- AI QË VREN DIKË NË MENYRË MIZORE (pashq.) / KËNGËTARJA AUSTRALIANE IMBRUGLIA (shqip.)
- ZANORE
- SËMUNDJE E FËMIJËVE, QË SHFAQET ME SHTREMBËRIMIN E ESHTRAVE
- ISH FUTBOLLISTI YNË I NJOHUR .... VOKRRI
- KONFERENCA ME KARAKTER NDËRKOMBËTAR / SHTET NË AZI
- ZË I THELLË MASHKULLI NË MES TË TENORIT DHE BASIT (shq.)
- KRYEQYTETI I NJË SHTETI EVRO-AZIATIK / I PËSHPËRIT DIKUJT FJALË MAGJIKE
- THIRRJE QË I BËHET MASËS
- FUTBOLLISTI BRAZILIAN .... ALVES (Barcelona)
- DY ZANORE / IRISH REPUBLICAN ARMY
- AKTORI YNË ZHITOPOTOKU / AZEM MAKSUTAJ
- GJENDJA FIZIOLOGJIKE E QENIEVE TË GJALLA
- QYTET UNIVERSITAR NË ANGLI (shq.) / ZANORE
- LYERJA ME LLAK / E PËRZIEJ, E TRAZOJ
- KYÇI, NYJA
- FRIKACAKE, IKACAKE / ANDORA
- POPULL (turq.) / ILION LIKA
- MJET SHPËRTHYES
- GJERMANI I VJETËR / SHKRIMTARI I NJOHUR AMERIKAN HEMINGUEJ
- SHKRONJA XXVIII / BOLTON, IPSVICH
- NORA ISTREFI / AKTORI MUÇAJ
- PJATA
- GJINI I KRIJIMTARISË LETRARE NË FORMË TREGIMI / 3.14 (mat.)
- VEPRIMTARI I SHQUAR KURTI (shq.) / FILM I REGJISORIT JAMES CAMERON
- PJESË E VITIT (sh.shq.)
- EPOKA E RE
- PJESË E MEKANIKËS QË STUDION LIGJET E LËVIZJES SË TRUPAVE
- BANORET E KRYEQYTETIT TË KANADASË
- PATTERN RECOGNITION RECEPTORS / QENGJ I BUTË
- SULM / MONZA
- NEGRI, ZEZAK (bised.) / METAL ME SHKËLQIM SI TË ARGJENDIT (shq.)
- BASHKËTINGËLLORE / AKTORJA ME FAMË BOTËRORE XHESIKA ....
- MBIZOTËRIM
- FUTBOLLISTI .... RAMIRO CORDOBA (Inter) / DY ZANORE
- NËNAT
- AKTORJA E VJETËR ... RINA
- ELTON ORLANDES / ZANORE
- PIKTORI .... VALLA (shq.) / PUSIA (sh.shq.)
- PJESË E LIMANIT KU QËNDROJNË ANIJET (shq.) / JETËSHKRIME
- FJALË POHUESE / ELECTRONIC MEDICAL RECORD
- PLANETI YNË / BOR, INDIUM
- "B" në mes të dy "N" / SHTET NË EVROPË
- BIMË E VISEVE TROPIKALE / AKTORJA HOLLIVUDIANE GARDNER
- DEM / SHKRIMTARI .... ZOLA
- PELLGU I HAPËT PËR TË GRUMBULLUAR UJË / MJET PËR SITJE
- DY ZANORE / VENDËS, RRËNJËS
- AKTORJA & KËNGËTARJA AMERIKANE WINNINGHAM
- EMËR I VJETËR PËR EGJIPTIN / SHKRONJA TË NJËJTA
- SËPATË E VOGËL ME TEH TË GJERË / AKTORJA E NJOHUR DEMI ..... (shqip.)
- TRIERI / NJË (ang. orgj.)
- IDRIZ SEFERI
- LUFTËTARI PËR TË DREJTAT E ZEZAKËVE LUTHER KING / NATRIUM
- QYTETI ITALIAN I MODËS / KANDY AMBER
- IGLI TARE
- SHTET NË AFRIKËS
- ARTIOLA TOSKA / SHKRONJA XIX
- NË ÇFARË VENDI
- HOVI, VRULLI / BASHKËTINGËLLORE
- KLUB FUTBOLLI ITALIAN
- AKTORI YNË ... ISLAMI
- EMËR YNI MASHKULLI

Lexues të nderuar, për vërejtje dhe sugjerime mund të shkruani në: fjalekryqi_beni@yahoo.com & gazmend78@hotmail.com

ZGJIDHJA E FJALËKRYQIT: LAURIMI, EKZAKT, ORIZI, Ç, NENI, ME, APA, BAR, RI, BORI, D, KATIL, BARITONI, ANKARAJA, APEL, DANI, AO, ADEM, JETA, ITONI, LLAKIMI, ANI, IKATARE, MILET, MINA, ALEMANI, T, NI, ENA, EPIKA, ALBINI, PRR, ATAK, I ZI, S, DOMINIM, IVAN, EMAT, ITA, EO, ESATI, MOLI, ANANAS, PO, TOKA, NBN, AVA, TER, BASENI, AE, MARE, MISIR, LATA, T, IS, MARTIN, MILANO, KENIA, AT, KU, ELANI, ATALANTA, ARD, ISET.

E rrallë

# Zbulohet anija me 200 tonë flori



Pas 113 vjetësh është zbuluar luftanija ruse "Dimitri Donskoi", e cila mendohet se mban 200 tonë flori, me vlerë rreth 133 miliardë dollarë. Anija e fundosur është zbuluar nga një ekip eksploruesish në brigjet e një ishulli në Korenë e Jugut.

## BARSOLETA E DITËS



**Një bionde hyn në një autobus me dy kate.**
**Shoferi i thotë: Hip në katin sipër.**
**Biondja hipën, por kthehet shpejt e frikësuar.**
**Shoferi i thotë: S'pat vend?**
**Biondja: S'kishte shofer aty.**

## FOTO E DITES



Konkurrentët luftojnë për topin gjatë një ndeshje në lojën me baltë në Brunsbuettel të Gjermanisë. /AFP/

E jashtëzakonshme

# Prodhohet birra e parë në botë nga kanabisi




Shkencëtarët në një laborator të vogël të Ontarios po testojnë enzima dhe eksperimentojnë me fermentimin e kanabisit. Teknikat e tyre nuk janë të reja, por fokusi i tyre është një risi për mbarë botën. Ata po zhvillojnë atë që përshkruhet si birra e parë në botë e prodhuar nga kanabisi. Shumica e birrave të kanabisit në treg janë joalkoolike, të prodhuara nga elbi dhe të mbushura me vaj marihuane.

KINO ABC PRISHTINE

## Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

**Vetem gjate vikendit**
**në ora 16:00**

### " INCREDIBLES 2" 3D

I Animuar/Aksion/Aventure; 1 ore 58 min

**Rolet:** Holly Hunter, Craig T. Nelson, Sarah Vowell, Huck Milner, Samuel L. Jackson, etj.

**Regjia:** Brad Bird







**Në ora 18:20**

### "FUTURE WORLD"

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

**Rolet:** James Franco, Suki Waterhouse, Milla Jovovich, Lucy Liu, Jeffrey Wahlberg, Snoop Dog, etj.

**Regjia:** James Franco

**Në ora 20:00**

### "ANT-MAN AND THE WASP" 3D

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 58 min

**Rolet:** Paul Rudd, Evangeline Lilly, Michael Pena, Michael Douglas, Michelle Pfeiffer, Laurence Fishburne, etj.

**Regjia:** Peyton Reed






**Në ora 22:00**

### "LOVING PABLO" (R)

Biografi/Krim/Drame; 2 ore 03 m

**Rolet:** Javier Bardem, Penélope Cruz, Peter Sarsgaard, etj.

**Regjia:** Fernando León de Aranoa

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Sot mund të ndiheni shumë të kënaqur nga arritjet e projekteve tuaja. Keni ditur se si t'i kombinoni idetë me praktikën në punë.



**DEMI**
Po ecni me hapa të avashtë sa iu përket çështjeve të zemrës. Çdo gjë rreth e qark po ju flet për situata të reja.



**BINJAKËT**
Dita do të nisë me një lajm që si fillim mund t'ju çorientojë disi, por që do të jetë mjaft optimist për të ardhmen.



**GAFORRJA**
Keni preferuar të jeni të drejtpërdrejtë me njerëzit sot, por kjo gjë do t'i lëkundë ndjeshëm raportet tuaja me kolegët.



**LUANI**
Sot jeni të pavendosur lidhur me çfarë do të bëni. Kjo gjë vjen për shkak të mosnjohjes së personave që do të keni përballë gjatë ditës.



**VIRGJËRESHA**
Ndonjëherë mund të vepronі edhe pa marrë miratimin e të tjerëve. Nëse vendosni të silleni në një mënyrë të caktuar sot, ndajeni mendjen me veten tuaj.



**PESHORJA**
Po vini në provë personat që keni pranë për të parë nëse janë në sintoni me ato që ju mendoni. Sot do të keni një surprizë të këndshme.



**AKREPI**
Ndonjëherë provoni të dëgjoni edhe ata që ju japin këshilla. Jo gjithmonë keni ju të drejtë për gjithçka.



**SHIGJETARI**
Po bëni gjithçka që të mos tregoni shqetësimin që ju ka shkaktuar një lajm që sapo dëgjuat. Nëse duhet të veproni duhet ta bëni tani.



**BRICJAPI**
Të gjithë do të mundohen t'ju kënaqin sot. Është një ditë e veçantë për ju dhe kjo gjë ju bën të ndiheni të përkëdhelur.



**UJORI**
Po mundoheni t'i modifikoni planet tuaja për të ardhmen sepse keni kuptuar që janë shumë më ambicioz sesa mundësitë tuaja reale.



**PESHQIT**
Dita sot do të ndryshojë komplet nga ajo që ju kishit parashikuar. E rëndësishme është të mos ju kapë paniku.




Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

| PROGNOZA SPORTIVE | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | HOBRO - FC COPENHAGEN | 2 | CS UNIVERSITATEA - CSMS IASI | GG3+ | HAMMARBY - DALKURD | 1 |

# Emri i Fadil Vokrrit zbukuron stadiumin e Prishtinës




Emri i legjendës së futbollit shqiptar, Fadil Vokrri, është vendosur të hënën në stadiumin e Prishtinës, në 58-vjetorin e lindjes së tij. Ndërsa Federata e Futbollit ka njoftuar se ndeshja e parë testuese do të zhvillohet më 28 korrik në mes të veteranëve të KF Flamurtari Vlorë dhe KF Prishtina

EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 23 KORRIK - Stadiumi i Prishtinës do të quhet "Fadil Vokrri". Emri i legjendës së futbollit është vendosur të hënën në hyrje të stadiumit ku Vokrri kaloi vitet më të mira si futbollist. Zëvendëskryeministri i parë i Kosovës dhe ministri i Jashtëm, Behgjet Pacolli, ka thënë se stadiumi i Prishtinës me plot meritë do të mbajë emrin e Vokrrit. "Stadiumi i Prishtinës, me plot meritë, nga sot quhet 'Fadil Vokrri'", ka shkruar Pacolli në "Facebook".

Ndërsa të martën Federata e Futbollit e Kosovës ka mbajtur konferencë për medie. Kryetari i ri i FFK-së, Agim Ademi, ka thënë se më 28 korrik do të zhvillohet ndeshja e parë testuese në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë. Në këtë ndeshje do të përballen veteranët e Flamurtarit të Vlorës dhe ata të KF Prishtina. "Ju njoftojmë për ndeshjen e cila do të zhvillohet më 28 korrik në stadiumin e qytetit që tashmë e ka marrë emrin 'Fadil Vokrri' në orën 20:00. Do të luajnë veteranët e Flamurtarit të Vlorës dhe veteranët e KF Prishtina. Këta ishin ndeshur edhe më herët. Qëllimi i kësaj ndeshje është për ta nderuar figurën e Fadil Vokrrit, por edhe për ta testuar stadiumin. Testimin do ta bëjnë inspektorët e UEFA-s. Testimi do të bëhet duke filluar nga qasja e shikuesve, qasjet rrugore, lëvizja e njerëzve jashtë dhe brenda stadiumit. Sistemet e kontrollit dhe sigurisë, infrastruktura sportive, hapësirat e brendshme sportive dhe të tjera. Siç thamë, pjesëmarrës do të jenë FC Prishtina, FC Flamurtari Vlorë dhe Estrada dhe politika do ta bëjnë një skuadër. Do të luhet me sistem secili me secilin për ta përmbushur kohën e plotë prej 90 minutave. Ndaj ftohen qytetarët të vijnë në numër sa më të madh. Biletat do t'i kenë falas dhe të pranishëm do të jenë inspektorët e UEFA-s të cilët do të bëjnë vlerësimin dhe do të japin leje për zhvillimin e ndeshjeve për Ligën e Kombeve që fillojnë në shtator, por edhe për ndeshjet e skuadrave tona që marrin pjesë në garat evropiane", ka thënë Ademi, i cili më pas ka kërkuar përkrahjen e medieve dhe të qytetarëve që të jenë në numër sa më të madh, pasi duhet të jenë të pranishëm 3 000 shikues. "Nevojitet një numër mbi 3 000 shikues për ta arritur numrin e duhur për testim, ku do të ketë edhe ketering falas. Besoj shumë se më 28 korrik në stadiumin 'Fadil Vokrri' do të jetë një numër i madh i adhuruesve dhe do të kemi vlerësim pozitiv. Kemi shtuar angazhimet tona, njëjtë edhe Ministria dhe punëkryesi ka zgjatur orarin dhe ka shtuar numrin e punëtorëve në mënyrë që më 28 korrik çdo gjë të jetë në nivelin e duhur dhe të kërkuar", ka deklaruar Ademi.

Në shenjë nderimi për ditëlindjen e kryetarit tashme të ndjerë të FFK-së, Fadil Vokrri, dy ish-klubet e tij, Llapi dhe Prishtina, kanë organizuar një ndeshje miqësore me veteranët, kurse "Dardanët" kanë bërë një koreografi të veçantë për nderim të figurës së ish-presidentit Fadil Vokrri.

## SHKURT

### Drita mëson kundërshtarin nëse e eliminon F91 Dudelangen

Skuadra e Dritës ende është pjesë e garave ndërkombëtare, pasi Prishtina është eliminuar nga Fola Esch. Ekipi gjilanas do të luajë në raundin e dytë të Ligës së Evropës pas eliminimit nga Liga e Kampionëve. Drita do të luajë ndaj kampionëve të Luksemburgut, F91 Dudelangen, që gjithashtu u eliminua nga Liga e Kampionëve. Nëse kampionia e Kosovës e eliminon F91 Dudelangen, atëherë do të takohet me fituesin e duelit Legia Warsaëa-Spartak Trnava. Ndeshja e parë në mes të Dritës dhe F91 Dudelangen do të zhvillohet në Luksemburg më 26 korrik, kurse e kthimit një javë më vonë në stadiumin "Adem Jashari" në Mitrovicë.

### Kosova zhvillon dy miqësore në Slloveni

Kombëtarja A e Kosovës në hendboll do të luajë dy ndeshje miqësore kontrolluese në Slloveni. Kosova do ta ketë përballë kombëtaren e Arabisë Saudite, ndërsa ndeshjet shërbejnë për të fituar përvojë lojtarët e rinj dhe për të provuar disa emra të rinj. Kombëtarja të shtunën është nisur për në Slloveni, ndërsa ka arritur në këtë vend të dielën. Ndeshja e parë luhet të martën, ndërsa e dyta të mërkurën. Kosova pritet të vazhdojë me miqësore cilësore edhe në vjeshtë. Në tetor janë planifikuar ndeshje me Luksemburgun dhe Turqinë.

### Maxhuni largohet nga Prishtina

Futbollisti Lorik Maxhuni ka konfirmuar lajmin se nuk do të jetë më pjesë e skuadrës së Prishtinës. "Kontrata ime me FC Prishtina ka mbaruar me përfundimin e garave ndërkombëtare. Falënderoj Prishtinën si dhe tifo grupin 'Plisat' për përkrahjen", ka thënë Maxhuni, i cili nuk ka treguar se në cilin klub do ta vazhdojë karrierën futbollistike.

## UEFA dënon Prishtinën

PRISHTINË, 23 KORRIK - FC Prishtina nëpërmjet një njoftimi për medie ka bërë me dije se është dënuar nga UEFA. Prishtina ka mbyllur aktivitetet në Evropë për edicionin 2018, ndërsa vazhdojnë vendimet rigoroze të UEFA-s kundër saj. Klubi është dënuar me 4 000 euro për fishekzjarrët e ndezura dhe të hedhura në ndeshjen e raundit preliminar në Mitrovicë kundër Evropa të Gjibraltarit. Edhe në edicionin e kaluar kundër Norrkopingut, Prishtina ishte dënuar me 3 000 euro për të njëjtën vepër.



## Latifi, Cormierit: Boll u fshehe, ma jep shansin që meritoj

PRISHTINË, 23 KORRIK - Daniel Cormier ka deklaruar se i kanë mbetur edhe dy ndeshje përpara se t'i varë dorezat në gozhdë, por kohët e fundit shumë luftëtarë e kanë sfiduar kampionin e dy peshave të ndryshme. I fundit është suedezi me origjinë shqiptare, Ilir Latifi, i cili ka fituar 5 nga 6 ndeshjet e fundit në UFC dhe aktualisht është një nga luftëtarët më në formë të peshës "light-heavyweight". "Kampion, përse vazhdon të fshihesh. Unë jam kundërshtari i duhur ndaj të cilit duhet ta mbrosh titullin. Nëse nuk do të ndeshesh me Alex, atëherë ndeshu me mua. Boll u fshehe kampion, ma jep mundësinë time. Respekt", ka shkruar Latifi në "Instagram". Daniel Cormier sapo ka mposhtur Stipe Miocic në peshën e rëndë dhe kërkon një ndeshje prej multi milionë dollarësh ndaj yllit të WWE, Brock Lesnar.



# Mavraj: Dua Evropianin me Shqipërinë

KOLN, 23 KORRIK - Pas divorcit me Hamburgun, mbrojtësi i Kombëtares, Mërgim Mavraj, ka zgjedhur për t'u rikthyer në qytetin e Kolnit, për t'i vijuar përgatitjet individuale deri në çastin e lidhjes me një skuadër të re. Gjatë qëndrimit në Koln, Mavraj nuk i ka shpëtuar intervistës me "Express.de". Mbrojtësi shqiptar ka folur gjerë e gjatë për situatën në të cilën ai ndodhet, të ardhmen si dhe për festën e Xhakës dhe Shaqirit në Botëror pas golave ndaj Serbisë.




*Mavraj, po stërviteni në Koln për ta mbajtur veten në formë, pse kjo zgjedhje?*

**Mavraj:** Kolni ka qenë dhe është një pjesë e rëndësishme e jetës sime. Tani është një moment i veçantë, pasi nuk ka diçka të sigurt për të ardhmen. Ndaj është e rëndësishme të jem këtu me miq të vërtetë. Mund të kisha shkuar të stërvitesha me Beni Kugel në Majorka, por këtu në Koln kushtet janë po aq të kompletuara.

*Cila tjetër? Ku do të shkoni?*

**Mavraj:** Është e vështirë të them se ku do të shkoj. Sigurisht, objektivi është që të jetë kategoria e parë, kudo. Ka disa opsione, këtu dhe jashtë. Në moshën 32-vjeçare nuk mendoj se jam pranë pensionit. Pa dyshim është edhe një shtysë për t'i ndëshkuar kritikët të cilët e thonë pikërisht këtë gjë.

*Te Kolni ishit një siguri. Pastaj mbrojtja dështoi. Ishte fatale për të dyja palët që u larguat, apo jo?*

**Mavraj:** Ishte rruga më e vështirë që zgjodhëm të dyja palët. Në fund, rezultati nuk ishte ai që kishim shpresuar. Megjithatë, Hamburgu ishte një përvojë e rëndësishme për jetën, ndonëse kapitulli u mbyll pa lavdi. Pa dyshim, unë do të kisha dashur të luaja në Evropë me Kolnin, për këtë nuk ka dyshime.

*Si e keni përjetuar nga distanca rënien e Kolnit nga kategoria, me dorëheqjen e Shtoger dhe Shmadtke?*

**Mavraj:** Ishte shumë e papritur, por kështu ndodh edhe në jetë. Suksesi sjell gabimet më të mëdha. Sigurisht, ka gjithmonë sinjale, por është e vështirë t'i shohësh ato kur je mirë. Kjo tashmë mund të aplikohet edhe me Federatën Gjermane. Sigurisht se u mërzita nga ajo që pashë, por edhe te Hamburgu nuk di të them në të vërtetë se cila ishte arsyeja e zhgënjimit, ndonëse isha vetë aty.

*Si e përjetuat Kupën e Botës? Duhet të keni ndjerë dhembje pasi luajtët një rol të mirë me Shqipërinë në "Euro 2016"…*

**Mavraj:** Ekipi kombëtar ka qenë motivimi im më i madh në muajt e fundit. Këtë dëshirë, për t'u kthyer diçka mbrapsht njerëzve të mi, kam arritur ta ruaj edhe në një çast të vështirë sportiv, në një moment kur njerëzit nuk kanë shumë respekt ndaj teje. Kjo dëshirë më ka mbajtur gjallë nga ana sportive. Është diçka e këndshme ta arrish Evropianin me Shqipërinë, dua të punoj për atë objektiv përsëri.

*A mund të na i shpjegoni gjestet e Xhakës dhe Shaqirit në Botëror pas golave me Serbinë që sollën kaq polemika?*

**Mavraj:** Historia luan një rol të madh. Ka qenë një periudhë e errët që nuk duhet të përsëritet. Ka pasur luftë në mes të Shqipërisë dhe Serbisë deri vonë. Fati e desh që prindërit e këtyre djemve të arratiseshin atëherë. Por këto vlera të origjinës, që njeriu i mban në vetvete, nuk harrohen. Xhaka e dashuron Zvicrën, por te Zvicra lufton si një shqiptar. Kjo do të thotë se ata këndojnë këngë shqiptare, festojnë martesat si shqiptarë, ruajnë traditat dhe festojnë me këto simbole. Është diçka e mirë që nuk fshihet një gjë e tillë nga një qenie njerëzore. Duhet të jesh tolerant. Dhe ajo që është më thelbësore, është se golat e tyre kanë ndihmuar më shumë Zvicrën se Shqipërinë.

*A kishte ndonjë shans të ktheheni te Koln?*

**Mavraj:** Unë nuk di të ketë pasur kontakte. Këto gjëra dalin kur prodhohen informacione përgjysmë. Sigurisht ishte e këndshme të luaja te Kolni, por e shoh skuadrën tani, është në një pozitë të mirë dhe ka cilësi. Pa dyshim pritshmëria te Hamburgu dhe Kolni është më e larta edhe në Ligën e Parë. Të gjithë presin të dominojnë që në ndeshjet e para, por unë ju them se do t'ia dalin. Cilësia në Bundesligën 2 nuk është aq e lartë. Sigurisht, diferencat mes skuadrave janë të vogla, por niveli nuk është aq i lartë.

## Parma mbetet në Serinë A, por i hiqen pesë pikë

ROMË, 23 KORRIK - Klubi italian do të luajë në Serinë A, kurse sulmuesi Emmanuele Calaio është dënuar me dy vjet moslojë. Parma mund të marrë frymë lirshëm. Skuadra italiane në sezonin 2018-2019 mbetet pjesë e Serisë A, të drejtë që e ka fituar në fushën e lojës, por ajo do ta nisë sezonin e ri me një dënim prej -5 pikësh në renditje. Gjykata italiane ka dhënë vendimin e saj në lidhje me klubin e sapo kthyer në Serinë A, duke i hequr pesë pikë nga klasifikimi, ndërsa ka dënuar me dy vjet moslojë sulmuesin Emanuele Calaio. Sulmuesi i Parmës ishte pikërisht ai që u kishte çuar disa mesazhe të dyshimta disa lojtarëve të Spezias në "WhatsApp" duke u kërkuar të mos luanin fort në ndeshjen e fundit të sezonit në Serinë B ndaj tyre. Parma rrezikonte rikthimin në Serinë B pikërisht për shkak të këtyre mesazheve, por ka shpëtuar vetëm me heqje të pikëve.




SHKURT

### Llullaku: Nuk mund të më dënojnë për shqiponjë

Azdren Llullaku festoi me "shqiponjë" golin kundër Steauas së Bukureshtit, por kjo është bërë temë diskutimi në mediet rumune, sepse prej këtij gjesti u penalizuan gjatë kampionatit botëror edhe Granit Xhaka me Xherdan Shaqirin. Llullaku ka sqaruar menjëherë se kjo mënyrë festimi është thjesht një gjest i kosovarëve dhe i shqiptarëve për të thënë se ata mendojnë për atdheun e tyre. "Nuk kam dashur të provokoj dhe të fyej askënd. Është një mënyrë e festimit e ne kosovarëve dhe nuk është një sfidë ndaj askujt. E bëjmë për t'i treguar atdheut tonë se mendojmë për të. Nuk ka pse të ketë ndonjë masë ndëshkimore, sepse nuk iu referova askujt. Jam i bindur se nuk do të ketë asnjë çështje disiplinore ndaj meje", ka thënë sulmuesi kuqezi për "digisport.ro".

### Vetteli i zhgënjyer pas humbjes në Gjermani

Piloti gjerman Sebastian Vettel ishte i zhgënjyeri pas garës në Gjermani. Katër herë kampioni i botës në Formula 1, i cili është në kërkim të titullit të tij të parë me Ferrarin, e di se gabimi që bëri në këtë pistë mund të ndikojë shumë në ecurinë e sezonit. "Bëra një gabim të vogël që pati një impakt shumë të rëndë. Po e menaxhonim shumë mirë garën deri në atë pikë ndërsa më pas gabova. Jam shumë i zhgënjyer, pasi deri në atë moment e kishim fitoren në xhep", ka deklaruar Vetteli.

### Wolverhampton transferon Moutinhon

Skuadra e inkuadruar në Premierë Ligë, Wolverhampton Wanderers, është përforcuar me mesfushorin Joao Moutinho. 31-vjeçari e ka braktisur skuadrën e Monacos për të nënshkruar kontratë dyvjeçare me skuadrën e Wolverhampton Wanderersit. Klubit anglez transferimi i mesfushorit portugez i ka kushtuar 5,6 milionë euro.

### Mourinho kërkon njërin nga këta qendërmbrojtës

Manchester United është i vendosur të nënshkruajë me një mbrojtës qendre në këtë afat kalimtar. Në listën e trajnerit Jose Mourinho janë tre futbollistë: Harry Maguire (Leicester City), Toby Alderweireld (Tottenham Hotspur) dhe Leonardo Bonucci (Milan). Reparti i mbrojtjes ka qenë më i dobëti në edicionin e fundit për skuadrën nga "Old Trafford".

### Pritet shkëmbimi Luiz-Rugani

Një shkëmbim futbollistësh mund të ndodhë në këtë afat kalimtar në mes të Juventusit dhe Chelseat. Skuadra kampione e Italisë, Juventus, është duke e monitoruar situatën e David Luizit në Chelsea, dhe duke parë mospërshirjen në planet e trajnerit të ri Maurizio Sarri, "Zonja e Vjetër" planifikon ta transferojë në Torino. Në anën tjetër anglezët e Chelseas po e kërkojnë mbrojtësin Daniele Rugani. Pritet një marrëveshje mes klubesh për shkëmbimin e këtyre dy qendërmbrojtësve.

## Njoftimi për shprehje të interesit

**Emri i shkollës:** "OiNSŠ „25. maj"
**Komuna:** Prizren
**Data:** 24 Korrik 2018
**Emri i kontratës** Trajnim i mësimdhënësve (përdorim i mjeteve të informatikës)
**Numri i kontratës:** ESIP/C1.3/081 - ESIP/SDG/081-CS/1.3

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit* (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles **OiNSŠ „25. maj"** Prizren. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i sherbimeve të nevojshme:

1. Përshkrimi i sherbimeve të nevojshme:
   - ***Trajnim i mësimdhënësve (përdorim i mjeteve të informatikës) ne Prizren***

2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:
   - Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 2 kontratave për ofrimin e sherbimeve të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
   - Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt termeve te references në adresën Adresa e Shkolles **OiNSŠ „25. maj"** , Prizren më së largu deri më **03.08. 2018.**

4. Termet e References së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për propozim do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre konsulenteve potencialë që i plotësojnë kriteret. Konsulentet luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e shprehjes së interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:

Personi kontaktues: **Asim Karadolami**
Numri i telefonit: **049-340-495**
e-mail: **asim-76@hotmail.com**

## Njoftimi për shprehje të interesit

**Emri i shkollës:** ShFMU "Krushë e Vogël," Krushë e Vogël
**Komuna:** Prizren
**Data:** 24 Korrik 2018
**Emri i kontratës** Organizimi i garave sportive
**Numri i kontratës:** ESIP/C1.3/086 - ESIP/SDG/086-CS/1.5

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit* (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles **ShFMU "Krushë e Vogël" Krushë e Vogël, Prizren**. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i sherbimeve të nevojshme:

1. Përshkrimi i sherbimeve të nevojshme:
   - Organizimi i garave sportive

2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:
   - Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 2 kontratave për ofrimin e sherbimeve të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
   - Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt termeve te references në adresën **ShFMU "Krushë e Vogël" Krushë e Vogël, Prizren** më së largu deri më **03.08. 2018**.

4. Termet e References së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për propozim do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre konsulenteve potencialë që i plotësojnë kriteret. Konsulentet luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e shprehjes së interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:

**Personi kontaktues:** Bedri Shehu
**Telefoni:** 044 215 970
**E-maili:** artimi2@hotmail.com

## Njoftimi për shprehje të interesit

**Emri i shkollës:** "ShFMU "GRNÇARE" - Grnçare dhe Novo Sello
**Komuna:** Prizren
**Data:** 24 Korrik 2018
**Emri i kontratës** Trajnim i mësimdhënësve
**Numri i kontratës:** ESIP/C1.3/085 - ESIP/SDG/085-CS/1.1

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit* (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles **SHFMU „GRNÇAR"** Prizren. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i sherbimeve të nevojshme:

1. Përshkrimi i sherbimeve të nevojshme:
   - ***Trajnim i mësimdhënësve (ne Prizren)***

2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:
   - Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 2 kontratave për ofrimin e sherbimeve të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
   - Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt termeve te references në adresën Adresa e Shkolles **ShFMU "GRNÇARE" - Grnçare dhe Novo Sello,** , Prizren më së largu deri më 03.08. 2018.

4. Termet e References së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për propozim do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre konsulenteve potencialë që i plotësojnë kriteret. Konsulentet luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e shprehjes së interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:

**Personi kontaktues:** Adis Mujo
**Telefoni:** 044 355 049
**E-maili:** adismujo@hotmail.com

**Shtojca 5: Njoftimi për shprehje të interesit**

## Njoftimi për shprehje të interesit

Emri i shkollës: **"Meto Bajraktari" - Reçan**
Komuna: Prizren
Data: **24.07. 2018**
Emri i kontratës: Sigurimi i drekes per pjesemarres ne aktivitetet shkollore

Numri i kontratës: ESIP/SDG/087-CS/1.6

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit* (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles **SHFMU"Meto Bajraktari" – Reçan/Prizren**. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i sherbimeve të nevojshme:

1. Përshkrimi i sherbimeve të nevojshme:
Sigurimi i drekes per pjesemarres ne aktivitetet shkollore

2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:
   - Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 2 kontratave për ofrimin e sherbimeve të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
   - Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt termeve te references në adresën Adresa e Shkolle **SHFMU"Meto Bajraktari"** në Reçan, 20530 Reçan - Prizren, më së largu deri më 03.08. 2018.

4. Termet e References së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për propozim do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre konsulenteve potencialë që i plotësojnë kriteret. Konsulentet luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e shprehjes së interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:

Personi kontaktues: Esad Kurejšepi,
+383 44 389 144 ,
meto.bajraktari@outlook.com

## Njoftimi për shprehje të interesit

**Emri i shkollës:** ShFMU "Nefit Jusufi"
**Komuna:** Prizren
**Data:** 24 Korrik 2018
**Emri i kontratës** Vizitë monumenteve historike të Kosovës
**Numri i kontratës:** ESIP/C1.3/088 - ESIP/SDG/088-CS/1.3

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit* (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles **SHFMU "Nefit Jusufi"** Prizren. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i sherbimeve të nevojshme:

1. Përshkrimi i sherbimeve të nevojshme:
   - Vizitë monumenteve historike të Kosovës

2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:
   - Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 2 kontratave për ofrimin e sherbimeve të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
   - Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt termeve te references në adresën Adresa e Shkolle **SHFMU "Nefit Jusufi"**, Prizren më së largu deri më **03.08. 2018.**

4. Termet e References së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për propozim do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre konsulenteve potencialë që i plotësojnë kriteret. Konsulentet luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e shprehjes së interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:

**Personi kontaktues: Ramit Jusufi**
**Nr. i telefonit: 044 621 341**
**E-mail:** shfmunefitjusufi@gmail.com

## Njoftimi për shprehje të interesit

**Emri i shkollës:** "Planjane"
**Komuna:** Prizren
**Data:** 24 Korrik 2018
**Emri i kontratës** Trajnimi i mësimdhënësve per mësimdhënie bashkëkohore
**Numri i kontratës:** ESIP/C1.3/089 - ESIP/SDG/089-CS/1.1

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit* (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles **"PLANJANE"** Recane. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i sherbimeve të nevojshme:

1. Përshkrimi i sherbimeve të nevojshme:

   - Trajnimi i mësimdhënësve per mësimdhënie bashkëkohore

2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:

   - Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 2 kontratave për ofrimin e sherbimeve të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
   - Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt termeve te references në adresën Planjane,20530, Recane më së largu deri më **03.08. 2018**

4. Termet e References së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për propozim do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre konsulenteve potencialë që i plotësojnë kriteret. Konsulentet luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e shprehjes së interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:

**Personi kontaktues:** Alen Azari
**Telefoni**: 044 356 448
**E-maili**: o.s.planjane@hotmail.com

## Njoftimi për shprehje të interesit

**Emri i shkollës:** **ONSŠ"Svjetlost"**
**Komuna:** Prizren
**Data:** 24 Korrik 2018
**Emri i kontratës** Hapja dhe mirembajtja e Web faqes se shkolles.
**Numri i kontratës:** ESIP/C1.3/090 - ESIP/SDG/090-CS/1.1

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit* (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles **ONSŠ"Svjetlost"** Prizren. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i sherbimeve të nevojshme:

1. Përshkrimi i sherbimeve të nevojshme:
   - Hapja dhe mirembajtja e Web faqes se shkolles.

2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:

   - Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 2 kontratave për ofrimin e sherbimeve të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
   - Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt termeve te references në adresën Adresa e Shkolle **ONSŠ"Svjetlost"** , Prizren më së largu deri më 03.08. 2018.

4. Termet e References së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për propozim do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre konsulenteve potencialë që i plotësojnë kriteret. Konsulentet luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e shprehjes së interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:

**Personi kontaktues:** Salija Bangoji
**Telefoni**: 044-389-055
**E-maili**: salija_72@hotmail.com

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Sanije Streli, B.I. shpallë të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330289282, me seli në Lipjan.

▶ "AS ENGINEERING" SH.P.K. shpallë të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330190918 me seli në magjistralen Prishtinë-Ferizaj.

▶ Lëshoj banesa me qira afër Eulex-it, ish Farmedi, në lagje të spitalit, banesa është e lirë që nga data 01.08.2018. Banesat janë të ndërtuar nga kompania "Cima Contrekshen" njëra banesë ka 112 metër katror ndërsa tjetra 85 metër katror. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 044-923-527 dhe 044-402-679.

▶ Urgjentisht kërkoj një banës me qera për një person te huaj, Banesa duhet te jete jo shumë larg qendrës, mundësisht tek "Qafa" ose "Tophane" Duhet te ketë dy dhoma gjumi, te jete e mobiluar bukur. Çmimi deri 300 euro. Për info: Tel 049-472-770

▶ Lëshoj me qira banesën në Prishtinë, Lagja Mati 1, rr. Ndue Perlleshi (pas 13 katshes). Banesa ka 58 m. katrorë, e mobiluar. Nr. kontaktues 044-121-668 ose 044-172-938. Çmimi sipas marrëveshjes.

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Fushë Kosovë, për një familje 3 anëtarësh. Banesa duhet të ketë 2 dhoma gjumi, dhomë dite, kuzhinë dhe poashtu të jetë e mobiluar. Banesa kërkohet për afat më të gjatë. Info në tel: 044-741-151

▶ Urgjentisht kërkoj banesë me qira për një çift ne Fushe Kosove. Banesa duhet te ketë një dhome gjumi dhomë dite me kuzhine te jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155

▶ Urgjentisht kërkoj banesë me qira ne Prishtine, për një qift me një fëmijë. Banesa duhet te ketë 1 dhome gjumi dhomë dite me kuzhine. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155

▶ Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

▶ Lëshoj me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehje qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958

▶ Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

▶ Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësojmë me korrektësi si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.

▶ Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknike në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.

▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783

▶ Kimete Lanaj B.I. kërkon një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ari, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.

▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

## Njoftimi për shprehje të interesit

**Emri i shkollës:** "Dëshmoret e Vrrinit"- Billushë
**Komuna:** Prizren
**Data:** 24 Korrik 2018
**Emri i kontratës** Furnizimi i shkollës me internet
**Numri i kontratës:** ESIP/C.1.3/084 - ESIP/SDG/084-CS /1.1

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit* (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkollës **"Dëshmoret e Vrrinit"**, Prizren. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i shërbimeve të nevojshme:

Përshkrimi i shërbimeve te nevojshme:

- Furnizimi i shkollës me internet.
- Instalimi i rrjetit në objektin e shkollës.

Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 2 kontratave për ofrimin e shërbimeve të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt specifikimit të hollësishëm teknik dhe termeve te referencës në adresën e Shkollës **"Dëshmoret e Vrrinit"**-Billushë, Prizren më së largu deri më **02 Gusht 2018.**

Specifikimi i hollësishëm teknik dhe termet e referencës së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për ofertë-shërbime do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre kontraktuesve potencialë që i plotësojnë kriteret. Kompanitë luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e shprehjes së interesit.

**Detajet kontaktuese të shkollës:**
**Personi kontaktues:** Florim Gashi
**Telefoni:** 044/757-404
**E-maili:** florimgashi2@hotmail.com

## Njoftimi për shprehje të interesit

**Emri i shkollës:** "Vëllezërit Frashëri"
**Komuna:** Prizren
**Data:** 24 Korrik 2018
**Emri i kontratës** Trajnim i mësimdhënësve
**Numri i kontratës:** ESIP/C.1.3/091 - ESIP/SDG/091-CS /1.1

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit* (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkollës **"Vëllezërit Frashëri"**,Prizren. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i shërbimeve të nevojshme:

Përshkrimi i shërbimeve te nevojshme:

- Trajnim: Gjithë përfshirja sociale në arsim dhe aftësim profesional të mësimdhënësve.

Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 2 kontratave për ofrimin e shërbimeve të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt specifikimit të hollësishëm teknik dhe termeve te referencës në adresën e Shkollës **"Vëllezërit Frashëri"**, Prizrenmë së largu deri më **02 Gusht 2018.**

Specifikimi i hollësishëm teknik dhe termet e referencës së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për ofertë-shërbime do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre kontraktuesve potencialë që i plotësojnë kriteret. Kompanitë luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e shprehjes së interesit.

**Detajet kontaktuese të shkollës:**
**Komuna:**Miran Ferati
**Telefoni**: 049/337-939
**E-maili**: mirock_508@hotmail.com



# Adil Spahiu

(1953-2007)

Plot 11 vite nga vdekja e kolegut tonë të nderuar. Qoftë i përjetshëm kujtimi për Ty.

E përkujton me respekt i gjithë kolektivi i KOSTT sha.a

Hidroregjioni Jugor

KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh.A, në Prizren

## NJOFTON

Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Hidroregjioni Jugor" Sh.A me seli në Prizren **anulon** Konkursin për plotësimin e vendit të punës: **Inspektor/kontrollor**-1 në Njësinë punuese Malishevë e shpallur me datën 05.07.2018, në shtypin ditor "Epoka e Re".

Kompania Rajonale e Ujësjellësit
"Hidroregjioni Jugor"Sh.A Prizren

## OBAVESTENJE

Regionalna Kompanija za Vodovod "Hidroregjioni Jugor" D.D. u Prizrenu **ponistava** konkurs za popunu radnog mesta: **Inspektor/kontrolor** -1 u Radnoj jedinici Malisevo i koji je objavljen dana 05.07.2018 u dnevnoj stampi"Epoka e Re".

Regionalna Kompanija za Vodovod
"Hidroregjioni Jugor"D.D.Prizren

MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

MINISTARSTVO KULTURE, OMLADINE I SPORTA/ MINISTRY OF CULTURE YOUTH AND SPORTS

DIVIZIONI I BURIMEVE NJERËZORE/ DIVIZION OF HUMAN RESOURCES/ DIVIZIJA LJUDSKIH IZVORA

Bazuar në Ligjin e Punës, Nr. 03/L-212 Ligji per Teatrot, Nr. 04/L-106 dhe Rregulloren Nr.05/2011, për Gradimin dhe Pagat e Krijuesve dhe Performuesve të Kulturës dhe te Punonjësve Professional të Trashëgimisë Kulturore, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit rishpall :

## KONKURS

**Titulli i punës:** Kostumograf /e

**Institucioni**: Teatri Kombëtar i Kosovës

**Kategoria funksionale:** Krijuesit dhe Performuesit e Kulturës- IX

**Paga:** Page fikse

**Numri i referencës:** 31/2018-R

**I përgjigjet**: Drejtorit të Teatrit Kombëtar të Kosovës

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

1. Bën përgatitjen dhe të mbaruarit e skicës kostumografike;
2. Kryen në mënyrë studiuese përgatitjen për punë kostumografike për shfaqje, mbledhë dhe studion dokumentacionin në bazë të veprës;
3. Punon skicat e kostumeve, 7 maskave, këpucëve, cilindrave, aplikacioneve, stolive, armëve etj.;
4. Dorëzon skicën e plotë kostumografike për të marr leje nga komisioni pas konsultimit me regjisorin dhe skenografinë;
5. Prezanton në të gjitha provat në punëtorinë e rrobaqepësisë në skenën e teatrit;
6. Bën patinimin e kostumeve.

**Shkollimi i kërkuar, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale:**

1. Diplomë e Fakultetit te Arteve, drejtimi -dizajn i skenografisë dhe kostumografisë;
2. Të ketë të realizuara kostumografitë, në 2 shfaqje, të paktën 1, në Teatrin Kombëtar të Kosovës (duhet dëshmohet me referenca nga regjisorët dhe kontrata );
3. Të ketë shkathtësi komunikimi dhe aftësi të punës në presion;
4. Njohja e gjuhës Angleze është përparësi .

**Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:** Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë mbaruar shkollimin e lartë adekuat dhe kanë aftësi profesionale për kryerjen e detyrave.

**Akte ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin:**Ligjin e Punës, Nr. 03/L-212, Ligjin per Teatrot, Nr. 04/L-106 dhe Rregulloren Nr.05/2011, për Gradimin dhe Pagat e Krijuesve dhe Performuesve të Kulturës dhe te Punonjësve Professional të Trashëgimisë Kulturore.

**Kohëzgjatja e emërimit:** Kandidati qe pranohet, përmes Konkursit publik, merr kontratë 6 mujore për periudhën provuese , me mundësi të vazhdimit sipas suksesit dhe angazhimit të treguar.

**Dokumentet e nevojshme që kërkohen:**

Kandidatët duhen ti dorëzojnë dokumentet e kompletuara si vijon:

- Diplomë e fakultetit të arteve, drejtimi- Dizajn i skenografisë dhe kostumografisë ;
- Dëshmitë me referenca nga regjisorët dhe kontrata, për 2 shfaqje të realizuara, të paktën 1, të realizuar në Teatrin Kombëtar të Kosovës;
- Dokumenti i identifikimit.

**Data e mbylljes së konkursit:** Konkursi është i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë pas ditës së shpalljes.

**Data e fundit e aplikimit është: 07.08.2018**

Aplikacionet e dërguara nëpërmjet postës, me pullë postare, në ditën e fundit të shpalljes, konsiderohen të vlefshme.
**Paraqitja e kërkesave:** Aplikacioni shkarkohet nga Ueb faqja e MKRS-së dhe dorëzohet në Zyrën 27 të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Sheshi "Nëna Tereze" Nr. 44. Për informata shtesë kontaktoni në numrat 038 211 921 dhe 038 211 449, apo në ueb-faqen http://www.mkrs-ks.org/)

MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

MINISTARSTVO KULTURE, OMLADINE I SPORTA/ MINISTRY OF CULTURE YOUTH AND SPORTS

DIVIZIONI I BURIMEVE NJERËZORE/ DIVIZION OF HUMAN RESOURCES/ DIVIZIJA LJUDSKIH IZVORA

Na osnovu Zakona o Radu, Br. 03/L-212, Zakona za Pozorišta, Br. 04/L-106 i Uredbe Br. 05/2011 za Stepenovanje i Plaćanje Stvaralaca i Izvođača Kulture i Profesionalnih Radnika Kulturnog Nasleđa, Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta, objavljuje:

## KONKURS

| | |
|---|---|
| **Naziv radnog mesta:** | Kostimograf |
| **Institucija**: | Nacionalno Pozorište Kosova |
| **Funkcionalna kategorija:** | Stvaraoci i izvođači kulture - IX |
| **Plata:** | Fiksna plata |
| **Broj upućivanja:** | 31/2018-R |
| **Odgovara**: | Direktoru Nacionalnog Pozorišta Kosova |

**Dužnosti i odgovornosti:**

1. Priprema i finalizuje kostimografsku skicu;
2. Na istraživački način priprema kostimografske radove za predstave, prikuplja i proučava dokumentaciju na osnovu dela;
3. Radi skice kostima, maska, cipela, cilindara, aplikacija, nakita, oružja, itd;
4. Upotpunjenu kostimografsku sliku dostavlja za dobijanje dozvole od komisije, nakon izvršenih konsultacija za režiserom i scenografom;
5. Na svim probama radionice krojača predstavlja na pozorišnoj sceni;
6. Vrši ispravke kostima.

**Traženo obrazovanje, iskustvo, sposobnosti i lične karakteristike:**

1. Diploma fakulteta umetnosti – smer dizajna scenografije i kostimografije;
2. Da je realizovao/a 2 predstave, a najmanje 1, pri Narodnom pozorištu Kosova (mora se dokazati preporukama režisera i ugovorom);
3. Da je komunikativna osoba i da poseduje sposobnosti rada pod pritiskom;
4. Poznavanje engleskog jezika je prednost.

**Uslovi učešća na kokursu:** Pravo na apliciranje imaju svi državljani Republike Kosova odraslog godišta, koji su sposobni da rade, koji su završili visoko adekvatno obrazovanje i koji poseduju profesionalne sposobnosti za vršenje dužnosti.

**Zakonski i podzakonski akti koji regulišu zapošljenje:** zakon o radu, br. 03/L-212, zakon o pozorištima, br. 04/L-106 i uredba br. 05/2011, za stepenovanje i plaćanje stvaralaca i izvođača kulture i profesionalnih radnika kulturnog nasleđa.

**Trajanje imenovanja:** Kandidati koji se prime putem javnog konkursa dobijaju ugovor na 6 meseci (probni rad), sa mogućnošću produženja po uspešnom angažovanju.

**Dokumenti koji se zahtevaju:**

Kandidati trebaju dostaviti sledeća upotpunjena dokumenta:

- Diplomu fakulteta umetnosti – smer dizajna scenografije i kostimografije;
- Dokaz i preporuke režisera i ugovor da je realizovao/la 2 predstave, najmanje 1, pri Nardonom pozorištu Kosova;
- Identifikacioni dokumenti.

**Datum zatvaranja konkursa:** Konkurs je otvoren petnaest (15) dana od datuma objavljivanja.

**Poslednji dan apliciranja je: 07.08.2018**

Aplikacije koje se dostave putem pošte, poštanskom markicom, na poslednji dan konkursa, smatraće se važećim.
**Podnošenje zahteva:** Aplikacija se preuzima sa veb stranice MKOS-a i dostavlja u kancelariji 27, ministarstva kulture, omladine i sporta, Trg "Majke Tereze", br. 44. Za dodatne informacije stupite u kontakt na brojeve telefona 038 211 921 i 038 211 449, ili na veb stranici (http://www.mkrs-ks.org/)




AUTOSHKOLLA
“RITMO – L”

Auto Shkolla
“RITMO - L”
Prishtinë

Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.

Ju mirëpret:
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "
Tel / kontakt:
044 248 173
044 200 604
044 375 333

